

BZgA

Bundeszentrale  
für  
gesundheitliche  
Aufklärung

# Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën dhe BZgA

## Standardet për edukimin seksual në Europë

*Kornizë konceptuale për  
vendimmarrës politikë,  
institucione arsimore,  
autoritete shëndetësore,  
ekspertë dhe eksperte*



EUROPE





# Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën dhe BZgA

## Standardet për edukimin seksual në Europë

Kornizë konceptuale për  
vendimmarrës politikë,  
institucione arsimore,  
autoritete shëndetësore,  
ekspertë dhe eksperte

Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung (BZgA)  
[Qendra Federale për Edukimin Shëndetësor]

Köln 2011

# Pasqyra e lëndës

<b>Parathënie</b>	<b>5</b>
<b>Pjesa 1: Hyrje</b>	<b>9</b>
<b>1. Historiku dhe objektivat</b>	<b>9</b>
1.1 Edukim seksual shkollor dhe jashtëshkollor	10
1.2 Konteksti historik i edukimit seksual shkollor	11
1.3 Zhvillimi i edukimit seksual shkollor në Europë	12
1.4 Larmia e qasjeve të pedagogjisë së edukimit seksual në Europë	13
1.5 Europa në kontekstin global	15
1.6 Nisma ndërkombëtare për edukimin seksual	16
<b>2. Seksualiteti, shëndeti seksual dhe edukimi seksual – Përkufizime dhe koncepte</b>	<b>18</b>
<b>3. Parimet themelore të edukimit seksual</b>	<b>24</b>
3.1 Reflektime bazë mbi edukimin seksual	24
3.2 Zhvillimi psikoseksual i fëmijëve	25
<b>4. Parimet dhe qëllimet e edukimit seksual</b>	<b>31</b>
<b>5. Grupet e synuara dhe partnerët e edukimit seksual</b>	<b>32</b>
<b>6. Si mund të bëhet me sukses edukimi seksual? – Kushtet e përgjithshme dhe kërkesat</b>	<b>33</b>
6.1 Shtatë karakteristika të edukimit seksual	33
6.2 Kualifikimi i stafit pedagogjik	35

## Pjesa 2: Matrica e edukimit seksual 37

### 1. Hyrje 37

1.1 Informacione rreth kontekstit 37

1.2 Rëndësia e strukturave mbështetëse 38

1.3 Pse është mirë që edukimi seksual të fillohet që para moshës katër vjeç 39

1.4 Shpjegime rreth matricës 40

### 2. Matrica 41

## Bibliografia 55

A. Referencat 55

B. Literatura shkencore mbi zhvillimin psikoseksual të fëmijëve 58

C. Planet mësimore dhe librat shkollorë 62

D. Faqe interneti 65



# Parathënie

Rajoni European i OBSH-së po përballet me një sërë problemesh në lidhje me «shëndetin seksual», duke përfshirë rritjen e infektiveve me SIDA dhe infeksione të tjera seksuale të transmetueshme (IST), shtatzëni të padëshiruara ndër adoleshente dhe dhunë seksuale. Fëmijët dhe adoleshentët luajnë një rol kryesor në përmirësimin e përgjithshëm të shëndetit seksual. Që ata të zhvillojnë një qëndrim pozitiv dhe të përgjegjshëm ndaj temës së seksualitetit, ata duhet të informohen për rreziqet, si dhe për mundësitë dhe potencialet e seksualitetit. Kjo u mundëson atyre një sjellje të përgjegjshme, jo vetëm me veten e tyre, por edhe me anëtarët e tjerë të shoqërisë në të cilën jetojnë.

Kjo kornizë konceptuale<sup>1</sup> rrjedh nga nevoja për pasjen e standarteve të edukimit seksual brenda Rajonit European të OBSH-së, i cili shtrihet nga Atlantiku në Paqësor dhe përfshin 53 vende. Megjithatë tashmë në shumicën e vendeve të Europës Perëndimore ka udhëzime kombëtare ose standarde minimale për edukimin seksual, prapë se prapë nuk janë bërë ende përpjekje për t'i rekomanduar këto standarde si të detyrueshme

në nivel të BE-së. Ky koncept është vetëm një hap i parë për të mbushur boshllëkun për të gjithë rajonin european të OBSH-së.

Për më tepër, këto standarde synojnë të mbështesin futjen e një edukimi seksual gjithëpërfshirës. Një edukim seksual gjithëpërfshirës u ofron fëmijëve dhe adoleshentëve informacion të paanshëm dhe shkencërisht të saktë për të gjitha aspektet e seksualitetit dhe në të njëjtën kohë i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë për t'i përdorur këto informacione në mënyrën e duhur. Kështu, atyre u jepet mundësia të zhvillojnë mendime plot respekt dhe tolerancë, të cilat në fund të fundit janë një parakusht për një shoqëri me drejtësi sociale.

Deri më tani, edukimi seksual ka qenë i përqëndruar kryesisht në rreziqet e mundshme që lidhen me seksualitetin, të tilla si shtatzënitë e paplanifikuara dhe sëmundjet seksuale të transmetueshme. Ky fokus negativ shpesh perceptohet nga fëmijët dhe adoleshentët si diçka kërcënuese. Për më tepër, ai nuk përputhet me nevojat e tyre për informacion dhe njohuri dhe shumë shpesh nuk ka asnjë lidhje me situatën e tyre jetësore.

Qasja gjithëpërfshirëse e trajton seksualitetin si një potencial të ekzistencës njerëzore dhe i ndihmon fëmijët dhe adoleshentët të zhvillojnë aftësi themelore, me ndihmën e të cilave ata mund të përcaktojnë vetë seksualitetin dhe marrëdhëniet e

<sup>1</sup> Korniza konceptuale është përpiluar në gjuhën angleze dhe botuar nga QFESH në vitin 2010 me titullin «Standards for Sexuality Education in Europe. A framework for policy makers, educational and health authorities and specialists» (Nr. i porosisë 60059500). Teksti aktual është përkthyer nga anglishtja.



Gjatë katër Workshop-ëve, të cilët janë organizuar nga BZgA midis muajve nëntor 2008 dhe dhjetor 2009, ekspertet i kanë zhvilluar bashkërisht standartet.



tyre në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre. Kjo i inkurajon ata që seksualitetin dhe marrëdhëniet e tyre t'i jetojnë në një mënyrë përmbushëse dhe të përgjegjshme. Këto aftësi kanë një rëndësi themelore për ta, në mënyrë që të jenë në gjendje ta mbrojnë veten nga rreziqet e mundshme.

Edukimi seksual është pjesë e edukimit të përgjithshëm dhe ndikon kështu në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Për shkak të natyrës së tij parandaluese, ai mundëson shmangien e pasojave negative të seksualitetit; në të njëjtën kohë ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës, të shëndetit dhe të mirëqenies së përgjithshme. Parë nga ky këndvështrim, edukimi seksual është një kontribut i rëndësishëm në ndihmën e përgjithshme shëndetësore.

Futja e edukimit seksual, veçanërisht nëpër shkolla, nuk është gjithmonë e lehtë – shpesh ka kundërshtime për shkak të shqetësimeve, frikësimeve dhe keqkuptimeve në lidhje me edukimin seksual. Ne shpresojmë të japim një kontribut pozitiv përmes këtyre standardeve, në mënyrë që shtetet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të futur për herë të parë edukimin seksual, ose për të zgjeruar programet ekzistuese në kuptimin e një edukimi seksual gjithëpërfshirës.

Kjo iniciativë nisi në vitin 2008 nga **Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën** dhe u zhvillua më tej nga **Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung (BZgA) [Qendra Federale e Edukimit Shëndetësor]**, një qendër bashkëpunimi e OBSH-së për seksualitetin dhe shëndetin riprodhues, në bashkëpunim të ngushtë me një grup ekspertësh. Ky grup përfshinte 19 ekspertë dhe eksperte nga nëntë vende të Europës Perëndimore me formime të ndryshme profesionale si mjekësia, psikologjia dhe shkenat shoqërore. Këta të gjithë kanë përvojë të gjerë teorike ose praktike në fushën e edukimit seksual. Organizatat qeveritare dhe joqeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe universitetet kanë qenë të përfshirë në këtë proces, i cili ka zgjatur më shumë se një vit e gjysëm dhe gjatë të cilit grupi u mbledh katër herë nëpër seminare. Palët e përfshira ranë dakord mbi këto standarde për edukimin seksual, të cilat duhet t'u shërbejnë shteteve si një udhëzim për futjen e edukimit seksual gjithëpërfshirës. Ato ofrojnë ndihmë praktike në zhvillimin e planeve mësimore të përshtatshme.

Njëkohësisht, ato mund të ndihmojnë si një mjet argumentimi për futjen e edukimit seksual gjithëpërfshirës në secilin shtet.

Ky botim është i ndarë në dy pjesë kryesore: Pjesa e parë ofron një përmbledhje rreth filozofisë mbi të cilën bazohet, sfondit, përkufizimeve dhe parimeve themelore të edukimit seksual dhe nënfushave të tij. Këtu prezantohet koncepti i edukimit seksual gjithëpërfshirës dhe shpjegohet, pse ai është kaq i rëndësishëm për adoleshentët dhe të rinjtë.

Në qendër të pjesës së dytë ndodhet një përmbledhje (matricë), në të cilën paraqiten temat, të cilat trajtojnë edukimin seksual për grupmoshat e ndryshme. Kjo pjesë është më shumë e përqendruar në zbatimin praktik të edukimit seksual gjithëpërfshirës në shkolla, edhe pse këto standarde nuk ishin konceptuar direkt si ndihmë për zbatim.

## Falënderime

Bundeszentrale für gesundheitliche Aufklärung (BZgA), si botuesi i këtyre standardeve u detyrohet falënderime të sinqerta shumë njerëzve: Dr. Gunta Lazdane nga Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën, e cila dha shtysën për këtë proces të rëndësishëm, dhe anëtarët e grupit të ekspertëve: Profesori Dan Apter (Klinika për Shëndetin Seksual, Väestöliitto), Doortje Braeken (International Planned Parenthood Federation – IPPF), Dr. Raisa Cacciatore (Klinika për Shëndetin Seksual, Väestöliitto), Dr. Marina Costa (PLANES, Fondacioni Zvicëran për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues), Dr. Peter Decat (International Centre for Reproductive Health, Universiteti Gent), Ada Dortch (IPPF), Erika Frans (SENSOA), Olaf Kapella (Institutit Austriak për Hulumtime Familjare, Universiteti i Vjenës), Dr. Evert Ketting (këshilltar për shëndetin seksual dhe

riprodhues dhe HIV/SIDA), Profesor Daniel Kunz (Universiteti i Shkencave të Aplikuar të Lucernit), Dr. Margareta Larsson (Universiteti i Uppsala), Dr. Olga Loeber (European Society for Contraception), Anna Martinez (Sex Education Forum, National Children's Bureau, Britani e Madhe), Dr. Kristien Michielsen (International Centre for Reproductive Health, Universiteti Gent), Ulla Ollendorff (Norwegian Directorate of Health), Dr. Simone Reuter (Contraception and Sexual Health Service, Nottinghamshire Community Health), Sanderijn van der Doef (World Population Foundation), Dr. Ineke van der Vlugt (Rutgers Nisso Group) dhe Ekua Yankah (UNESCO), të cilët punuan të gjithë pa u lodhur dhe me interes të madh në këtë projekt. Ishte kënaqësi të punoje me kolege dhe kolegë kaq të përkushtuar.

# Pjesa 1:

## Hyrje

### 1. Historiku dhe qëllimi

Ky botim prezanton standardet e rekomanduara për edukimin seksual. Ato japin informacion në lidhje me atë që fëmijët dhe të rinjtë e moshave të ndryshme duhet të dinë dhe të kuptojnë, ç'situata dhe probleme mund të përballojnë në këto faza dhe ç'qëndrime duhet të zhvillojnë në mënyrë që të mund të zhvillohen pozitivisht, shëndetshëm dhe të kënaqur edhe nga pikëpamja seksuale.

Këto standarde mund të merren si një kërkesë për zhvillimin dhe zgjerimin e planeve mësimore në nivele të ndryshme arsimore. Ato kanë për qëllim të bindin vendimmarrësit politikë për rëndësinë e futjes së edukimit seksual ose zgjerimin e qasjeve ekzistuese. Standardet shërbejnë si një pikënisje e mirë për një dialog rreth edukimit seksual me vendimmarrësit përkatës dhe grupet e interesit në këtë fushë. Nëse ato do të përdoren për të zhvilluar ose përmirësuar planet mësimore ekzistuese, ato duhet të përshtaten në përputhje me nevojat përkatëse dhe situatën e secilit vend. Ato ndihmojnë të përcaktojnë hapat vijues drejt

një edukimi seksual gjithëpërfshirës dhe shërbejnë si orientim për përpilimin e objektivave mësimore, gjë që është një pjesë thelbësore e çdo kurrikule.<sup>2</sup>

Ky koncept është krijuar si përgjigje e nevojës së lindur kohëve të fundit për standarde mbi edukimin seksual brenda Rajonit Europian të OBSH-së. Vende të ndryshme europiane i janë drejtuar Zyrës Rajonale të OBSH-së për Europën për ndihmë në krijimin e programeve të edukimit seksual. Standardet europiane, të cilat bazohen në përvojën e vendeve europiane me një histori të gjatë të edukimit dhe që paraqesin njohuritë e grumbulluara përkatëse të ekspertëve dhe eksperteve europiane në shumë vende, formojnë bazën ideale për zhvillimin e programeve të tilla.

2 Në fushën e edukimit seksual ka një larmi të madhe aktiviteteve dhe iniciativash. Në seksionin C të bibliografisë gjenden materiale dhe mjete ndihmëse mbi aspekte të ndryshme të edukimit seksual. Databaza e UNESCO-s si dhe përmbledhjet e shumta të BZgA dhe IPPF mbi edukimin seksual në Europë shërbejnë si një pikënisje e mirë për zhvillimin fillestar të planeve mësimore, krahaso UNESCO HIV and AIDS Education Clearinghouse; IPPF (2006a, 2007), Lazarus & Liljestrand (2007), si dhe BZgA/Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën (2006).

### **«Nevoja të reja» për edukim seksual**

Zhvillime të shumta gjatë dekadave të fundit kanë qenë vendimtare në lindjen e nevojës për edukim seksual. Këtu përfshihet globalizimi dhe migrimi i grupimeve të reja etnike me prejardhje të ndryshme kulturore dhe fetare, përhapja e shpejtë e mediave të reja, veçanërisht e internetit dhe telefonit celular, shfaqja dhe përhapja e HIV/SIDA dhe shqetësimet në rritje në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve dhe adoleshentëve, po ashtu edhe një mendim i ndryshuar kundrejt seksualitetit si dhe një sjellje e ndryshuar seksuale e adoleshentëve. Këto zhvillime të reja kërkojnë strategji efektive që t'u mundësojnë adoleshentëve ta trajtojnë seksualitetin e tyre në mënyrë të sigurtë dhe të kënaqshme. Një edukim seksual shkollor me baza të forta krijon kushte të mira për të arritur shumicën e personave brenda këtij grupi të synuar.

Për më tepër, standardet europiane mund të jenë një ndihmë e vlefshme si për vendet më të zhvilluara, ashtu edhe për ato më pak të zhvilluara jashtë Europës. Shumë prej këtyre vendeve hedhin sytë nga Europa në pritje për të mësuar nga ajo, dhe shumë shtete europiane dhe organizata joqeveritare i mbështesin këto vende në zhvillimin e edukimit seksual aty.

Për ta kuptuar siç duhet, së pari duhet të trajtohet se ç'rol mund të luajnë këto standarde në praktikë – duke patur parasysh zhvillimin psikoseksual në moshën e fëmijërisë dhe adoleshencës si dhe larminë e madhe shoqërore, kulturore, fetare dhe të tjera që ndikojnë në këtë proces.

## **1.1 Edukim seksual shkollor dhe jashtëshkollor**

Ndërsa rriten, fëmijët dhe adoleshentët gradualisht fitojnë njohuri për trupin e njeriut, marrëdhëniet intime dhe seksualitetin, dhe krijojnë për to ide, qëndrime dhe aftësi përkatëse. Në këtë proces mësimi, ata përdorin shumë burime të ndryshme. Ndër më domethënëset, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit, janë burimet jashtëshkollore siç janë prindërit, të cilët janë më të rëndësishmit gjatë fëmijërisë së hershme. Ekspertët mjekësorë,

pedagogjikë, sociopedagogjikë ose psikologjikë zakonisht luajnë një rol të pakët në këtë proces, çka është e kuptueshme, pasi mbështetja profesionale kërkohet pothuajse vetëm kur shfaqen probleme – probleme që mund të zgjidhen vetëm me ndihmën e një eksperti/eksperteje. Sidoqoftë, në qarqet kulturore perëndimore, për shkak të rëndësisë përgjithësisht në rritje të parandalimit, i cili po shtrihet gjithnjë e më shumë edhe në fushat intime dhe seksuale, është ngritur zëri për një përfshirje më të madhe të specialistëve edhe në këtë fushë.

### **Rëndësia e një qasjeje profesionale pozitive**

Siç e përmendëm tashmë, procesi i të mësuarit në fushën e seksualitetit zhvillohet kryesisht pa ndikimin e ekspertëve. Padyshim që seksualiteti njerëzor është i vështirë të «formohet» përmes edukimit shkollor, dhe roli i pedagogjisë seksuale është i përqëndruar kryesisht tek problemet (të tilla si shtatzënitë e paplanifikuara dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme – STI) dhe si të shmangen ato. Kjo çon shpejt në qortimin, se qasja e tyre është kryesisht negative, pra e orientuar ndaj problemeve. Ky fokusim tek problemet dhe rreziqet jo gjithmonë përkon me etjen për dije, interesat, nevojat dhe përvojat e të rinjve dhe shpesh nuk arrin efektin e synuar. Nga kjo rezulton edhe kërkesa për një qasje më pozitive, që është jo vetëm më efektive, por edhe më realiste. Për zhvillimin e edukimit seksual, karakteristike është përpjekja intensive për të ndërthurur një qasje profesionale dhe parandaluese me synimin për t'u ofruar të rinjve mundësi të përshtatshme, të dobishme, të pranueshme dhe tërheqëse.

### **Të rinjtë kanë nevojë si për edukim seksual shkollor ashtu edhe jashtëshkollor**

Duhet të theksohet, se të rinjtë kanë nevojë si për edukim seksual shkollor, ashtu edhe jashtëshkollor të cilët plotësojnë njëri-tjetrin: Nga njëra anë, të rinjtë, në rrethin e tyre të zakonshëm social, kanë nevojë për dashuri, hapësira lirie dhe mbështetje për të zhvilluar identitetin e tyre seksual; nga ana tjetër, ata duhet të fitojnë njohuri, qëndrime dhe aftësi të caktuara – këtu ekspertët/ekspertet luajnë një rol të rëndësishëm. Informacionet më të rëndësishme profesionale dhe ofertat arsimore përcillen përmes shkollave, përmes librave të specializuar, broshurave, fletëpalosjeve, CD-ROM-ve, faqeve të internetit me oferta arsimore,

programeve dhe iniciativave arsimore në radio dhe televizion si dhe përgjegjësve të shërbimeve (mjekësore).

Ky koncept trajton në radhë të parë edukimin seksual shkollor, që nuk do të thotë se shkolla është përcuesja e vetme e rëndësishme.

## 1.2 Konteksti historik i edukimit seksual shkollor

### Lindja e termit «adoleshencë» në kuadër të «Revolucionit Seksual» në vitet 1970

Futja e edukimit seksual shkollor në Europën Perëndimore përkon përgjithësisht me përhapjen e përgjithshme të metodave kontraceptive moderne dhe të besueshme, në veçanti të «pilulës kontraceptive», dhe me legalizimin e abortit në shumicën e vendeve gjatë viteve 1970 dhe 1980. Këto zhvillime inovative hapën mundësi krejtësisht të reja për ndarjen e seksualitetit dhe riprodhimit nga njëri-tjetri. Ky ndryshim shkaktoi një «revolucion seksual» rreth vitit 1970 dhe nxiti procesin e emancipimit femëror. Hyri një ndryshim i normave dhe vlerave seksuale, po ashtu edhe sjellja seksuale filloi të ndryshojë, ose të paktën të humbasë statusin e saj jashtëzakonisht tabu. Seksualiteti u bë një temë, për të cilën mund të flitej hapur. Në këtë proces lindi edhe një fazë e re jetësore midis fëmijërisë dhe moshës madhore, e cila u quajt si «adoleshencë». Kjo fazë e ndërmjetme karakterizohet si koha e rritjes së pavarësisë nga prindërit, e krijimit të marrëdhënieve dashurore dhe të kontakteve seksuale (herët) përpara martesës, e të bashkëjetuarit pa certifikatë martesore dhe e shtyrjes së martesës dhe krijimit të familjes për një kohë të mëvonshme. Në përgjithësi, të rinjtë në Europë, në fillim të mijëvjeçarit të tretë, kontaktet e tyre të para seksuale i kanë midis moshës 16 dhe 18 vjeç. Para se të martohen rreth moshës 25 vjeç (ose të bashkëjetojnë përgjithmonë), ata tashmë kanë patur partnerë të ndryshëm; me fëmijën e tyre të parë bëhen midis moshës 28 dhe 30 vjeç.<sup>3</sup> Në këtë fazë, domethënë para se të hyhet në një lidhje të qëndrueshme, si nga pikëpamja personale

ashtu edhe në aspektin e shëndetit publik, dy janë rreziqet më të rëndësishme: shtatzënia e padëshiruar dhe rreziku i infektimit përmes kontaktit seksual. Përhapja e epidemisë së HIV/SIDA-s në vitet 1980 të shekullit të kaluar solli me vete një rrezik akoma më të madh, i cili çoi në masa të gjera parandaluese. Në rritjen e interesit për seksualitetin e të rinjve dhe shëndetin seksual, vendimtarë qenë gjithashtu edhe faktorë të tjerë: Abuzimi seksual dhe dhuna seksuale, përherë tema tabu, filluan të tematizoheshin gjithnjë e më shumë në publik dhe ngjallën zemërim moral dhe dëshirën për parandalim efektiv. Tek «seksualizimi» i mediave dhe reklamave po perceptoheshin gjithnjë e më shumë ndikime negative në zhvillimin seksual të të rinjve dhe u kërkuan të merreshin masa si kundërpeshë.

### Edukimi seksual shkollor – si përgjigje ndaj këtyre ndryshimeve shoqërore

Këto ndryshime themelore shoqërore dhe në veçanti lindja e një faze të re shoqërore midis fëmijërisë dhe moshës madhore me një kulturë të vetën, me modele sjelljeje dhe nevoja të veta, kërkuan përgjigje të reja nga ana e shoqërisë. Në fushën e seksualitetit u bënë të nevojshme lloje të reja të shërbimeve shëndetësore ose një përshtatje e ofertave ekzistuese, si dhe iniciativa të reja ndërgjegjësuere dhe edukative. Kërkesa për edukim seksual në gjysmën e dytë të shekullit XX në Europë duhet parë kryesisht nga ky këndvështrim. Në veçanti, perceptimi i të drejtave të njeriut dhe mendimet e ndryshuara lidhur me të kundrejt të drejtave (seksuale) dhe roleve të kësaj grupmoshe specifike në shoqëri kanë kontribuar fort, që edukimi seksual të shihej tashmë si një domosdoshmëri. Duhet theksuar, se ky proces ka ndodhur në të gjitha vendet europiane, edhe pse disa vende e kanë ndjekur këtë rrugë më herët ose më shpejt se të tjerat. Edukimi seksual, veçanërisht siç ofrohet në shkollë, është një pjesë themelore e këtij procesi përshtatjeje. Arsytet për të kërkuar futjen e edukimit seksual shkollor kanë ndryshuar me kalimin e viteve dhe janë të ndryshme nga vendi në vend. Ato variojnë nga shmangia e shtatzënieve të padëshiruara deri tek parandalimi i HIV-it dhe infeksioneve të tjera seksualisht të transmetueshme. Edhe skandalet rreth abuzimit seksual nxitën interesin publik për edukim seksual dhe thirrën për një edukim seksual të fëmijëve më të vegjël. Këto kërkesa bazohen në një perceptim gjerësisht të

<sup>3</sup> krh. OECD (2008). Shih gjithashtu Zyrë Rajonale e OBSH-së për Europën (2008).

ndryshuar ndaj fëmijëve, që tashmë po shiheshin si subjekte.<sup>4</sup> Këto motivime të ndryshme janë puqur gradualisht dhe janë zhvilluar në një drejtim që karakterizohet nga një vështrim më gjithëpërfshirës i edukimit seksual. Vendimtare për këtë gjë ishte bindja, se të rinjtë duhet të ndihmohen, fuqizohen dhe t'u krijohet aftësia ta trajtojnë seksualitetin e tyre në një mënyrë të përgjegjshme, të sigurtë dhe të kënaqshme. Tema të veçanta ose treguesit e rreziqeve nuk duhet të qëndrojnë në plan të parë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse, e cila përcjell një koncept shumë më të gjerë të seksualitetit, jo të fokusuar vetëm në marrëdhëniet seksuale, mbrohet nga shumica e ekspertëve të seksualitetit dhe shëndetit seksual në Europë.

### 1.3 Zhvillimi i edukimit seksual shkollor në Europë<sup>5</sup>

Edukimi seksual si lëndë mësimore në Europë ka një histori që i kalon të pesëdhjetë vjetët dhe prandaj është më e gjata nga kudo tjetër në botë. Zyrtarisht ai filloi në Suedi në vitin 1955, kur u shpall lëndë e detyrueshme në të gjitha shkollat. Në praktikë, integrimi i kësaj lënde në planet mësimore zgjati shumë vjet, pasi për zhvillimin e udhëzuesve, manualeve dhe materialeve të tjera mësimore si dhe trajnimin e mësuesve u desh shumë kohë.

#### **Edukimi seksual u zhvillua më herët në Europën Perëndimore...**

Në vitet 1970 dhe 1980, edukimi seksual u miratua nga shumë vende të tjera të Europës Perëndimore, së pari në pjesën tjetër të vendeve skandinave, dhe pastaj edhe në vende të tjera. Për shembull, në Gjermani ai u fut në vitin 1968, në Austri në vitin 1970. Në Holandë dhe Zvicër ai filloi po ashtu në vitet 1970, edhe pse aty meqë shkollat (ose kantonet në rastin e Zvicrës) ishin kryesisht të pavarura, ai

nuk u bë menjëherë lëndë e detyrueshme.<sup>6</sup> Futja e edukimit seksual nëpër shkolla zgjati deri në dekadën e fundit të shekullit të 20-të dhe dekadën e parë të shekullit të 21-të, së pari hyri në Francë, Britani të Madhe dhe në disa vende të Europës Perëndimore dhe më vonë gradualisht në vendet e Europës Jugore, veçanërisht në Portugali dhe Spanjë. Madje edhe në Irlandë, ku tradicionalisht ka pasur kundërshtime me motive të forta fetare, edukimi seksual u bë i detyrueshëm në shkollat fillore dhe të mesme në vitin 2003. Vetëm në disa pak shtete anëtare «të vjetra» të BE-së, veçanërisht në Europën jugore, nuk ka akoma edukim seksual në shkolla deri më sot.

#### **... sesa në Europën Qëndrore dhe Lindore**

Në Europën Qëndrore dhe Lindore, edukimi seksual filloi të zhvillohej pas dështimit të komunizmit. Më parë, kishte pasur disa përparime në vende të veçanta, por, të para në retrospektivë, këto vështirëse mund të quhen si nisma për edukim seksual. Në shumicën e rasteve, këto ishin masa për «t'u përgatitur për martesë dhe familje», ku mohohej fakti se të rinjtë gradualisht mund të zhvillojnë një interes të fortë për lidhje dashurore dhe mund të jenë seksualisht aktiv që para martesës. Përgatitja për seksualitetin nuk ishte pothuaj fare temë. Prandaj, vendet në Europën Qendrore dhe Lindore edukimin seksual, ashtu siç përkufizohet dhe praktikohet në shumicën e vendeve sot, e filluan 20 ose 30 vjet më vonë se në Europën Perëndimore. Vetëm në disa nga këto vende, veçanërisht në Republikën Çeke dhe Estoni, janë bërë përpjekje serioze për të zhvilluar koncepte moderne të edukimit seksual që ndryshojnë nga edukimi familjar. Në një sërë vendesh të tjera të Europës Qendrore dhe Lindore ky trend kohët e fundit është ngadalësuar nga shfaqja e një fundamentalizmi (të motivuar politikisht, kulturor dhe fetar) në qarqe të ndryshme publike.

#### **Asnjë shkëmbim standardesh dhe udhëzuesish midis shteteve**

Lidhur me zhvillimin e udhëzuesve, planeve mësimore apo standardeve për edukimin seksual, midis vendeve europiane deri më tani ka pasur krejt pak shkëmbim. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak

4 Sipas kësaj, fëmija perceptohet si një person i pavarur me aftësi dhe nevoja të veçanta, veçanërisht në lidhje me mënyrën se si e shpreh afërsinë, sensualitetin dhe kuriozitetin (fizik). Potenciali i fëmijës kërkon një nxitje të përshtatshme.

5 Informacioni mbi edukimin seksual në shkolla bazohet kryesisht në raportet SAFE, shih IPPF (2006a, 2007), Lazarus & Liljestrand (2007).

6 Në Holandë, ai kurrë nuk e mori krejtësisht statusin e një lënde të detyrueshme dhe në Zvicër vetëm dy dekada më vonë, kur shpërtheu epidemia e SIDA-s.

të barrierave gjuhësore, veçanërisht pasi vetëm pak dokumente janë përkthyer dhe botuar në revista të specializuara ndërkombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për kërkimet në këtë fushë. Hulmimet shkencore mbi nevojat arsimore të rinjve ose mbi cilësinë dhe efektivitetin e masave arsimore janë kryer kryesisht për interesat e një vendi të veçantë dhe janë botuar në gjuhën përkatëse të atij vendi dhe nuk është futur në rrjedhën e njohurive shkencore ndërkombëtare. Për këtë arsye, nuk është për t'u habitur, se në përmbledhjen më të fundit të studimeve mbi efektet e edukimit seksual të përfshira në «International Technical Guidance on Sexuality Education» të UNESCO-s<sup>7</sup> mund të përfshiheshin vetëm njëmbëdhjetë studime nga «vendet e tjera të industrializuara» kundrejt 47 studimeve të kryera në Shtetet e Bashkuara. Shumica e këtyre njëmbëdhjetë studimeve europiane vijnë nga Britania e Madhe dhe vetëm pak nga të gjitha vendet e tjera europiane të marra së bashku. Kjo mund të krijojë lehtësisht përshtypjen se në Europë nuk ka interes për studime rreth edukimit seksual, çka duke pasur parasysh sa më sipër do të ishte një supozim i gabuar.<sup>8</sup> Europa ka një përvojë të pasur dhe me shumë mundësi një fond shkencor të dokumentuar mirë në vendet e veçanta. Ky duhet bërë i arritshëm ndërkombëtarisht përmes një publikimi më sistematik të studimeve dhe rezultateve të tyre.

## 1.4 Larmia e qasjeve të pedagogjisë së edukimit seksual në Europë

Se si mund të përdoren standardet e paraqitura këtu, varet kryesisht nga mënyra se si organizohet dhe përçohet edukimi seksual. Këtu ka dallime të mëdha brenda Europës. Për të përfituar sa më shumë nga përdorimi i standarteve, fillimisht është thelbësore të jepen disa informacione rreth këtyre dallimeve dhe prejardhjes së tyre.

### Për një edukim seksual gjithëpërfshirës dhe të hershëm

Ka dallime të mëdha në të gjithë Europën për sa i përket moshës në të cilën fillohet me edukimin seksual. Sipas raportit SAFE<sup>9</sup>, kjo shtrihet midis moshës pesë vjeç në Portugali dhe 14 vjeç në Spanjë, Itali dhe Qipro. Por po të vëzhgohet më hollësisht, del se dallimet nuk janë aq të mëdha sa duken në shikim të parë. Ata kanë të bëjnë më shumë me atë që nënkuptohet me «edukim seksual». Për këtë koncept përdoret një përkufizim i gjerë, që përfshin jo vetëm aspektet fizike, emocionale dhe interaktive të seksualitetit dhe të kontakteve seksuale, por edhe një sërë aspektesh të tjera të tilla si miqësia ose ndjenja e sigurisë, ngrohtësisë dhe e tërheqjes. Bazuar në këtë term përgjithësues, është e kuptueshme pse në shumë vende edukimi seksual fillon që në shkollën fillore ose ciklin e ulët. Aty ku ky fillon zyrtarisht vetëm në shkollën e mesme, zakonisht përdoret një përkufizim shumë më i ngushtë i seksualitetit. Këto dallime terminologjike shpjegojnë gjithashtu, pse në disa vende preferohet termi «seksualiteti dhe edukimi i partneritetit» apo shprehje të ngjashme kundrejt termit «edukim seksual».

Ne kemi zgjedhur qëllimisht një qasje, sipas së cilës edukimi seksual fillon që me lindjen. Që kur lindin, foshnjat mësojnë se ç'vlerë ka kontakti fizik, ngrohtësia dhe intimiteti dhe ç'kënaqësi të japin ato. Ato mësojnë se ç'është «e pastër» dhe ç'është «e pisët» dhe më vonë mësojnë ndryshimin midis mashkullit dhe femrës, si dhe midis njerëzve të njohur dhe të huaj. Fakt është, se veçanërisht prindërit u përcjellin fëmijëve të tyre që nga lindja mesazhe në lidhje me trupin e njeriut dhe intimitetin. Me fjalë të tjera: ata japin edukim seksual.

### Edukimi seksual duhet të jetë i përshtatshëm për moshën

Në këtë kontekst, termi «i përshtatshëm për moshën» është i rëndësishëm. Në fakt, më e saktë do të ishte shprehja «e përshtatshme me zhvillimin», pasi fëmijët zhvillohen me shpejtësi të ndryshme. Sidoqoftë, ne këtu përdorim termin i përshtatshëm për moshën dhe nënkuptojmë i përshtatshëm me moshën dhe zhvillimin. Ky

7 Krh. UNESCO (2009a).

8 Shih gjithashtu kapitullin 1.5, «Europa në kontekstin global».

9 S. IPPF (2006a).

cilësim ka lidhje me zhvillimin gradual të asaj çka është me interes dhe rëndësi duke filluar nga një moshë apo fazë e caktuar e zhvillimit dhe cilat detaje duhet të tematizohen. Kur një fëmijë katërvjeçar pyet nga vijnë bebet, përgjigja «nga barku i mamit» është zakonisht e mjaftueshme dhe e përshtatshme për moshën. Vetëm më vonë fëmija ndoshta pyet: «Si futet fëmija në barkun e mamit?» Në këtë moshë, ndoshta një përgjigje tjetër mund të jetë e përshtatshme për moshën. Një përgjigje e papërshtatshme do të ishte: «Je akoma shumë i vogël për këtë.» Termi «i përshtatshëm për moshën» shpjegon, pse gjatë edukimit seksual të njëjtat tema duhet të trajtohen rishtas në grupmosha të ndryshme – me rritjen e moshës tema trajtohet më intensivisht.

### **Edukimi seksual si lëndë ndërdisiplinore**

Edhe lënda mësimore, në të cilën kryhet edukimi seksual dhe kualifikimet e mësuesve përgjegjës janë po ashtu krejt të ndryshme brenda Europës. Ndonjëherë edukimi seksual është një lëndë e veçantë, por zakonisht integrohet në lëndë të tjera. Biologjia duket e kuptueshme, por në varësi të vendit, llojit të shkollës dhe kushteve të tjera, ajo mund të zhvillohet edhe në lëndët e edukimit politik, orientimit social ose kompetencës sociale, (ruajtjes së) shëndetit, filozofisë, fesë, gjuhëve ose sportit. Përbajtjet dhe metodat e përdorura varen kryesisht nga lënda bazë dhe edukimi paraprak i mësuesit. Nëse edukimi seksual zhvillohet në kuadër të mësimin të biologjisë ose edukimit shëndetësor, atëherë fokusi ka prirje të jetë drejt aspekteve fizike, ndërsa në lëndët shoqërore në plan të parë qëndrojnë elementet sociale, interaktive ose etike.

Për një edukim seksual gjithëpërfshirës, dobi sjell, nëse ai kryhet nga mësues të lëndëve të ndryshme dhe kështu trajtohet në një mënyrë ndërdisiplinore.<sup>10</sup> Megjithatë përvoja tregon, se është e rëndësishme që përgjegjësia për koordinimin qendror të materialeve dhe informacioneve të ndryshme të përqëndrohet tek një mësues i vetëm. Një qasje tjetër që përdoret shpesh është edhe sjellja në shkollë e specialistëve, të cilët pastaj trajtojnë aty tema të veçanta. Këta mund të jenë

mjeke/ë, infermiere/ë, mamë, punonjës/e sociale ose psikologe/ë të trajnuar posaçërisht për edukim seksual. Shpesh, për këto qëllime përdoren edhe institucione private të shërbimeve të shëndetit seksual ose të kujdesit shëndetësor për të rinjtë. Në disa vende, të tilla si Suedia ose Estonia, një pjesë e edukimit seksual zhvillohet në qendrat e afërta shëndetësore për të rinj. Kjo mendohet të ulë pengesat emocionale që mund të shkaktojnë vizitimi i këtyre qendrave dhe nxit përdorimin e tyre në të ardhmen si pika të para kontakti.

Përfshirja e edukimit seksual (dhe edukimit të partneritetit) si lëndë e detyrueshme në kurikulum luan një rol të rëndësishëm në mësimdhënien e kësaj lënde. Siç tregon përvoja në disa vende, prirja është që edukimit seksual t'i kushtohet më pak vëmendje sapo të hiqet statusi i detyrueshëm. Nga ana tjetër, dhënia e statusit të detyrueshëm nuk do të thotë automatikisht cilësi më e mirë dhe arsimim tërësor. Gjithashtu i nevojshëm është edhe një proces nga poshtë-lart, në të cilin mësuesit motivohen, trajnohen dhe mbështeten. Në dekadat e fundit, tendenca e përgjithshme në Europë ka qenë që edukimi seksual të bëhet një lëndë e detyrueshme, pa rregulla përjashtimore që t'i lejonte prindërit t'i hiqnin fëmijët e tyre nga mësimi, nëse do të kishin diçka kundër përbajtjes mësimore. Në praktikë, prindërit (përfshirë ata që i përkasin një pakice) shpesh e mbështesin edukimin seksual shkollor, pasi ata vetë nuk zotërojnë njohuritë e mjaftueshme për temën ose kjo temë i vë në siklet.

Këtu është e rëndësishme të theksohet se edukimi seksual nuk është pothuaj asnjëherë një lëndë provimi, edhe pse kjo do të ishte e mendueshme për ndonjë pjesë në tërësinë e temave të tij, nëse do të ishte i përfshirë në një lëndë të detyrueshme siç është biologjia. Në mënyrë që ai të fitojë më shumë rëndësi, do të ishte e dëshirueshme, që të bëhet një lëndë provimi.

Për zhvillimin e planit mësimor është mirë që të krijohet një formë fikse e bashkëpunimit me prindërit – jo vetëm për të siguruar mbështetjen e nevojshme të tyre, por edhe për të siguruar koordinimin optimal midis rolit jashtëshkollor të prindërve dhe rolit institucional të shkollës. Ky bashkëpunim madje kërkohet zyrtarisht në të paktën një vend evropian (Austri). Shkolla

10 Në Francë, edukimi seksual jepet mësim nga shumë mësues të ndryshëm.



sigurisht që nuk është institucioni apo organizata e vetme që mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë fushë. Shumë organizata të tjera që janë në kontakt të ngushtë me fëmijët dhe të rinjtë, po ashtu dhe mediat, mund të japin kontribute të vlefshme.

Së fundmi, vendimtare është edhe shkalla e decentralizimit të autoriteteve përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e planeve mësimore – përfshirë këtu edhe edukimin seksual. Prandaj, edukimi seksual mund të ndërtohet shumë ndryshe në shtete të ndryshme. Në një vend si Suedia, për shembull, që ka tradicionalisht një sistem arsimor të centralizuar, edhe kurrikulat caktohen nga qendra. Kurse në vende të tjera me një kulturë të ngjashme, si Danimarka apo Holanda, vendimet merren nga autoritetet arsimore lokale ose shkollat e veçanta.

## 1.5 Europa në kontekstin global

Një përmbledhje ndërkombëtare e studimeve vlerësuese të programeve të edukimit seksual të publikuara nga UNESCO tregon, se këto tani po zbatohen në shumë vende të industrializuara dhe në zhvillim.<sup>11</sup> Shumë nga programet e aplikuar në vendet në zhvillim bazohen tek ato të vendeve të industrializuara, veçanërisht atyre të SHBA-së dhe Europës Perëndimore, në disa raste atyre u jepet gjithashtu edhe mbështetja përkatëse.

### Tre kategori programesh

Nga perspektiva historike, globale, programet e edukimit seksual mund të ndahen në tre kategori të mëdha.

1. Programet që synojnë kryesisht ose ekskluzivisht heqjen dorë nga marrëdhëniet paramartesore dhe njihen si «programet e abstenimit» (lloji 1).
2. Programet që përfshijnë abstenimin si mundësi, por që tematizojnë edhe kontraceptivët dhe marrëdhëniet e mbrojtura seksuale. Këto

programe në krahasim me «abstinimin e pastër» shpesh quhen «edukim seksual i përgjithshëm» (lloji 2).

3. Programe që përmbajnë elemente të llojit 2, por që i vendosin këto në një kontekst më të gjerë të rritjes dhe zhvillimit të personalitetit dhe seksualitetit. Këto programe cilësohen këtu si «edukim seksual gjithëpërfshirës» (lloji 3).

Programet e llojit të parë në dhjetë vitet e fundit kanë marrë fonde dhe mbështetje të gjera nga Partia Republikane në Shtetet e Bashkuara dhe kanë patur ndikim në zhvillimet në pjesë të tjera të botës, veçanërisht në disa vende në zhvillim dhe vendet e Europës Lindore. Programet e llojit të dytë janë zhvilluar si reagim ndaj qasjes së abstinimit. Një studim krahasues për efektet e llojit të parë dhe të dytë në Shtetet e Bashkuara tregon, se programet e abstinimit nuk kanë efekte pozitive në sjelljen seksuale dhe vazhdojnë të bartin rrezikun e shtatzënive ndër adoleshente, ndërsa strategjitë gjithëpërfshirëse kanë efektet e dëshiruara pozitive.<sup>12</sup>

Kufijtë midis programeve të llojit të parë dhe të dytë janë të rrjedhshëm, në varësi të karakteristikave përkatëse.

Fatkeqësisht, në Shtetet e Bashkuara ka pothuajse ekskluzivisht programe të kategorisë së parë dhe të dytë, ndërsa në Europën Perëndimore mbizotërojnë programet e llojit të tretë. Literatura ndërkombëtare e specializuar në edukimin seksual publikohet – gati mund të thuhet s’do mend – në gjuhën angleze. Megjithatë, shumica e dokumenteve mbi edukimin seksual në Europë, të tilla si udhëzuesit, manualët, materiali mësimor apo edhe raportet vlerësuese, janë shkruar në gjuhën përkatëse kombëtare. Meqenëse këto zakonisht nuk janë të arritshme për lexuesit ndërkombëtarë, mund të krijohet lehtë përshtypja se përveç programeve në gjuhën angleze, shumica e të cilave vijnë nga SHBA, pothuaj nuk ka programe të tjera.

Në këtë pikë duhet theksuar se programet e llojit 3 bazohen në një filozofi të ndryshme nga ato të llojit 1 dhe 2. Këto të fundit synojnë kryesisht të kenë

<sup>11</sup> Shih UNESCO et al. (2009a), 13 vv.

<sup>12</sup> Krh. Kohler et al. (2008).

më shumë rezultate të matshme dhe përqëndrohen veçanërisht në rezultatet specifike të sjelljes. Pyetje të rëndësishme në lidhje me vlerësimin e kurrikulave të edukimit seksual përfshijnë ndër të tjera: A ngadalësohet mosha e marrëdhënieve të para seksuale? A zvogëlohet numri i partnerëve seksualë? Madje edhe: A zvogëlohet shpeshtësia e marrëdhënieve seksuale?

Në Europë, edukimi seksual është i orientuar kryesisht drejt zhvillimit të personalitetit, ndërsa në SHBA ka kryesisht për qëllim zgjidhjen ose parandalimin e problemeve. Për këtë ndryshim themelor ka një sërë arsyesh historike, shoqërore dhe kulturore që nuk mund të diskutohen në këtë kontekst, por që është e rëndësishme të theksohen në këtë pikë. Në Europën Perëndimore, seksualiteti, siç krijohet dhe zhvillohet tek të rinjtë, nuk perceptohet kryesisht si një problem apo kërcënim, por më tepër si një pasurim i çmuar i personalitetit vetjak.

## 1.6 Nisma ndërkombëtare për edukimin seksual

Rekomandimi i këtushëm për Standarte Europiane për edukimin seksual është një plotësim i nismave të tjera europiane dhe botërore për nxitjen e një edukimi seksual me cilësi të lartë.

Në vitin 2001 u botua «WHO European Regional Strategy on Sexual and Reproductive Health». <sup>13</sup> Kjo strategji e vlefshme për dhjetë vjet u kërkonte shteteve anëtare, që të informonin dhe edukonin të rinjtë për të gjitha aspektet e seksualitetit dhe riprodhimit dhe t'i ndihmonin ata të zhvillonin aftësitë jetësore të nevojshme për t'u përballur me këtë çështje në një mënyrë të kënaqshme dhe të përgjegjshme. Gjithashtu duhej të krijoheshin kushtet ligjore dhe arsimore, në të cilat u rishikuan ligjet dhe politikat, nëse ato garantonin një akses të barabartë në shëndetin riprodhues dhe seksual.

Në nëntor të vitit 2006 BZgA dhe Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën organizuan në Köln një

konferencë mbarëeuropiane me titullin «**Youth Sex Education in a Multicultural Europe**». Kjo konferencë u ofroi 100 ekspertëve dhe eksperteve nga 26 vende një forum për të prezantuar dhe diskutuar strategji dhe nisma të suksesshme për edukimin seksual në vendet e veçanta. Ajo gjithashtu përkrahu një ndërlidhje dhe bashkëpunim më të madh në këtë fushë brenda Rajonit Europian të OBSH-së. Gjatë përgatitjes së konferencës, hapi i parë ishte mbledhja e një koleksioni «**Country Papers on Youth Sex Education in Europe**»<sup>14</sup> për të grumbulluar përvojat tashmë ekzistuese rreth edukimit seksual në 16 vendet europiane. Standardet që tashmë gjenden këtu janë një hap i mëtejshëm në zhvillimin e një edukimit seksual të njëtrajtshëm në Europë.

Pothuajse në të njëjtën kohë me konferencën në Köln, u botuan rezultatet e para të projektit «**SAFE**» (Sexual Awareness for Europe). Ky projekt nisi në vitin 2005 si një iniciativë e rrjetit europian IPPF dhe të 26 shoqatave të tij anëtare me pjesëmarrjen e Universitetit Lund (Suedi) dhe Zyrës Rajonale të OBSH-së për Europën. Komisioni Europian (Drejtoria e Përgjithshme për Shëndetin dhe Mbrojtjen e Konsumatorit) ishte i përfshirë në financimin e tij. Qëllimi i këtij partneriteti është të promovojë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat përkatëse të të rinjve në Europë. Nga ky projekt i gjerë dhe novator dolën tre raporte themelore:<sup>15</sup> Në këtë hyrje i referohemi hollësisht njërit prej këtyre raporteve, atij me titull «**Reference Guide to Policies and Practices in Sexuality Education in Europe**». Në udhëzimet e tij të projektit, ndër të tjera, u dha rekomandimi, «to ensure that comprehensive sexuality education is a mandatory subject both, for primary and secondary schools, with clearly set minimum standards and teaching objectives.»<sup>16</sup> Pavarësisht konceptimit të tyre të pavarur, këto standarde për edukimin seksual duhet të shihen si një plotësim i rezultateve të këtij projekti të SAFE-s.

13 Krh. Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën (1999/2001).

14 BZgA/Zyra Rajonale e OBSH-së për Europën (2006).

15 Krh. IPPF (2006a, 2007), Lazarus & Liljestrand (2007).

16 «... për të siguruar që edukimi seksual gjithëpërfshirës të jetë një lëndë mësimore e detyrueshme në shkollat fillore dhe të mesme me standarde minimale dhe qëllime mësimore të përcaktuara qartë.» IPPF (2007), f.18. (Referencat u referohen gjithmonë citimeve në anglisht në tekst; përkthimet janë bërë në kuadër të këtij botimi.)

Në vitin 2009 UNESCO (së bashku me organizata të tjera të OKB-së) botuan një udhëzues me dy vëllime me titullin «**Technical Guidance on Sexuality Education**».<sup>17</sup> Një shkëmbim informacioni dhe mendimesh me autorët e këtij udhëzuesi u zhvillua në fazën e dytë të zhvillimit të këtyre standardeve. Të dy dokumentet përkojnë pjesërisht, megjithatë rekomandimet e dokumentit të UNESCO -s kanë karakter global, ndërsa ky ka të bëjë më shumë me Europën.

Në vitin 2009 Population Council botoi një manual mbi edukimin seksual të titulluar: «**It is All One Curriculum. Guidelines and Activities for a Unified Approach to Sexuality, Gender, HIV, and Human Rights Education**». Ky udhëzues u përpilua nga një grup pune me pjesëmarrjen e shumë organizatave joqeveritare, mes tyre edhe të IPPF-së.<sup>18</sup>

Kjo përmbledhje tregon qartë, se në dhjetë vitet e fundit kanë lindur një sërë nismash për edukimin seksual. Qëllimi i standardeve të këtushme është të mbyllë një boshkllëk specifik në Europë duke përfshirë botimet e mëparshme dhe ato aktuale.

---

17 UNESCO (2009a, 2009b).

18 Krh. Population Council (2009).

## 2. Seksualiteti, shëndeti seksual dhe edukimi seksual – Përkufizime dhe koncepte

Termet gjini, seksualitet, shëndet seksual dhe të drejta seksuale dhe idetë e lidhura me to interpretohen deri në një farë pike ndryshe në vende dhe kultura të ndryshme.<sup>19</sup> Nëse ato përkthehen në gjuhë të tjera, ato prapë mund të kuptohen ndryshe. Prandaj për përdorimin e këtyre termave duhet të bëhen disa vërejtje sqaruese.

Në janar të vitit 2002, Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh) në kuadër të një nisme me bazë të gjerë mbledhi një konferencë specialistësh me qëllim përkufizimin e disa prej këtyre termave dhe koncepteve, pasi deri atëherë nuk kishte asnjë përkufizim, për të cilin të ishte rënë dakord ndërkombëtarisht.<sup>20</sup> Kjo çoi në një përcaktim paraprak të termave gjini, seksualitet, shëndet seksual dhe të drejta seksuale. Edhe pse këto përkufizime nuk janë ende përkufizime zyrtare të OBSh-së, ato tashmë gjenden në faqen e internetit të OBSh -së dhe po përdoren gjithnjë e më shpesh. Edhe në këtë koncept ato përdoren si terma pune:

**«Gjinia»** cilëson karakteristikat biologjike, me anë të të cilave njerëzit dallohen përgjithësisht në meshkuj dhe femra.

**«Seksualiteti»** në kuptimin më të gjerë përkufizohet sipas përkufizimeve paraprake të OBSh si më poshtë: «Human sexuality is a natural part of human development through every phase of life and includes physical, psychological and social components [...]».<sup>21</sup>

Një përkufizim më i plotë i propozuar nga OBSh-ja është:

**«Sexuality** is a central aspect of being human throughout life and encompasses sex, gender

identities and roles, sexual orientation, eroticism, pleasure, intimacy and reproduction. Sexuality is experienced and expressed in thoughts, fantasies, desires, beliefs, attitudes, values, behaviours, practices, roles and relationships. While sexuality can include all of these dimensions, not all of them are always experienced or expressed. Sexuality is influenced by the interaction of biological, psychological, social, economic, political, ethical, legal, historical, religious and spiritual factors.»<sup>22</sup>

Ky përkufizim është shumë i dobishëm për shumë arsye. Ai thekson se seksualiteti është një përbërës qendror i qenies njerëzore, ai nuk kufizohet në grupmosha të caktuara, është i lidhur ngushtë me gjininë shoqërore (gender), merr parasysh orientimet e ndryshme seksuale dhe nuk kufizohet vetëm tek riprodhimi. Ai bën gjithashtu të qartë se seksualiteti përfshin më shumë sesa thjesht mënyra sjelljeje dhe se ai mund të ndryshojë shumë në varësi të një numri të madh faktorësh ndikues. Përkufizimi në mënyrë indirekte bën të qartë, se edukimi seksual, i kuptuar në këtë mënyrë, mbulon gjithashtu një fushë shumë më të madhe dhe më të larmishme sesa edukata seksuale, i cili synon vetëm ndryshimin e sjelljes seksuale («education on sexual behaviour»). Fatkeqësisht, termat ndonjëherë ngatërrohen me njëri-tjetrin.

19 Shih edhe kapitullin 1.

20 OBSh (2006).

21 «Seksualiteti njerëzor është një pjesë e natyrshme e zhvillimit njerëzor në çdo fazë të jetës dhe përfshin përbërës fizikë, psikologjikë dhe socialë [...]» Zyra Rajonale e OBSh-së për Evropën (1999/2001), f.13.

22 «Seksualiteti përbën një aspekt qendror të qenies njerëzore gjatë gjithë jetës, i cili përfshin gjininë biologjike, identitetin gjinor, rolin gjinor, orientimin seksual, epshin, erotikën, intimitetin dhe riprodhimin. Ajo përjetohet dhe shprehet përmes mendimeve, fantazive, dëshirave, bindjeve, qëndrimeve, vlerave, sjelljeve, praktikve, roleve dhe marrëdhënieve. Ndërsa seksualiteti mund të përfshijë të gjitha këto aspekte, jo gjithmonë të gjitha dimensionet e tij përjetohen apo shprehen kurdoherë. Seksualiteti ndikohet nga ndërveprimi i faktorëve biologjikë, psikologjikë, shoqërorë, ekonomikë, politikë, etikë, ligjorë, fetarë dhe shpirtërorë ». OBSh (2006), f.10.

«**Shëndeti seksual**» u përkufizua për herë të parë nga OBSH-ja në vitin 1972 në një konferencë të specializuar<sup>23</sup> me formulimin e mëposhtëm:

«**Sexual health** is the integration of the somatic, emotional, intellectual and social aspects of sexual being in ways that are positively enriching and that enhance personality, communication and love».

Edhe pse ky është një përkufizim mjaft i vjetëruar, ai ende përdoret shpesh. Gjatë konferencës specialistike në vitin 2002 u miratua një skicë përkufizimi i ri. Versioni i ri skicë nga viti 2002 thotë:

«Sexual health is a state of physical, emotional, mental and social well-being in relation to sexuality; it is not merely the absence of disease, dysfunction or infirmity. Sexual health requires a positive and respectful approach to sexuality and sexual relationships, as well as the possibility of having pleasurable and safe sexual experiences, free of coercion, discrimination and violence. For sexual health to be attained and maintained, the sexual rights of all persons must be respected, protected and fulfilled.»<sup>24</sup>

Kjo skicë përkufizimi jo vetëm që thekson domosdoshmërinë e një qasjeje pozitive, aspektin thelbësor të kënaqësisë dhe idenë se shëndeti seksual përfshin jo vetëm aspekte fizike, por edhe emocionale, mendore dhe sociale, por gjithashtu vë në pah edhe anët e mundshme negative dhe e përmend për herë të parë ekzistencën e të drejtave seksuale – dy çështje që mungojnë pothuajse tërësisht në përkufizimin i vitit 1972. Përveç kësaj, aty nuk theksohen në mënyrë specifike aspektet

e mundshme negative, siç ndodh shpesh në literaturën për HIV dhe SIDA rreth kësaj teme. Me pak fjalë, ky është një përkufizim i ekuilibruar.

Shëndeti seksual është një nga pesë temat thelbësore të strategjisë globale të OBSH-së për shëndetin riprodhues, e cila u shpall nga «World Health Assembly» (Asambleja Botërore e Shëndetit) në vitin 2004.<sup>25</sup>

Është e rëndësishme të ceket, se që nga fillimi i viteve 1950, OBSH-ja ka zgjedhur një përkufizim dhe qasje shumë të gjerë dhe pozitive në lidhje me «shëndetin», duke e përshkruar atë si «potencial njerëzor» e jo thjesht si mungesë të sëmundjes dhe përmbledh jo vetëm aspekte fizike, por gjithashtu edhe emocionale, mendore, sociale dhe të tjera. Për këto arsye të fundit, përkufizimet e OBSH-së konsiderohen si një pikënisje e pranueshme dhe e përshtatshme për një diskutim rreth edukimit seksual. Kështu, në këtë koncept përdoret termi «shëndet seksual», por ky përmban gjithashtu edhe kuptimin e «mirëqenies seksuale». Shëndeti seksual ndikohet jo vetëm prej faktorëve personalë, por edhe prej faktorëve shoqërorë dhe kulturorë.

**Të drejtat seksuale** – duke përfshirë shprehimisht edhe të drejtën për informacion dhe edukim. Siç u përmend tashmë, konferenca specialistike e OBSH-së e vitit 2002 nxori një skicë përkufizimi rreth të drejtave seksuale me formulimin e mëposhtëm:

«**Sexual rights** embrace human rights that are already recognized in national laws, international human rights documents and other consensus statements. They include the right of all persons, free of coercion, discrimination and violence, to:

- the highest attainable standard of sexual health, including access to sexual and reproductive health care services;
- seek, receive and impart information related to sexuality;
- sexuality education;
- respect for bodily integrity;
- choose their partner;
- decide to be sexually active or not;
- consensual sexual relations;
- consensual marriage;

23 «Shëndeti seksual është integrimi i aspekteve fizike, emocionale, mendore dhe shoqërore të ekzistencës seksuale në një mënyrë pozitive, e cila kontribuon në pasurimin dhe zhvillimin të mëtejshëm të personalitetit, komunikimit dhe dashurisë.» OBSH (1975).

24 «Shëndeti seksual është gjendja e mirëqenies fizike, emocionale, mendore dhe shoqërore në lidhje me seksualitetin dhe nuk nënkupton vetëm mungesën e sëmundjeve, të mosfunksionimit ose dobësisë. Shëndeti seksual kërkon një qasje pozitive, respektuese ndaj seksualitetit dhe marrëdhënieve seksuale, si dhe mundësinë për përvojë seksuale të kënaqshme dhe të sigurta, larg shtypjes, diskriminimit dhe dhunës. Për të arritur dhe ruajtur shëndetin seksual, duhet të njihen, mbrohen dhe respektohen të drejtat seksuale të të gjithë njerëzve.» OBSH (2006), f.10.

25 OBSH (2004), f.21

- decide whether or not, and when, to have children; and
- pursue a satisfying, safe and pleasurable sexual life.

detyrimin që kanë shtetet, që përmes masave edukative, të mbrojnë fëmijët ndër të tjera nga abuzimi seksual.<sup>27</sup>

The responsible exercise of human rights requires that all persons respect the rights of others.»<sup>26</sup>

Edhe pse kjo është vetëm një skicë përkufizimi, ajo do të përdoret si pikënisje në këtë dokument, pasi mendohet se detajet që përmban do të pranohen gjërisht në Europë. E drejta për informacion dhe edukim përfshihet shprehimisht në këtë përkufizim, e cila për rëndësinë që ka përmendet sërish.

Sidoqoftë, këtu këshillohet kujdes. Pa dyshim që disa nga të drejtat e lartpërmendura u konceptuan për të rriturit. Kjo do të thotë, se jo të gjitha këto të drejta mund të zbatohen drejtpërdrejt për fëmijët dhe të rinjtë. Për shembull, është e qartë se çështje të tilla si martesë konsensuale ose e drejta për të vendosur lirisht për prindërimin nuk janë ende relevante për fëmijët ose të rinjtë në fillim të pubertetit.

E drejta e fëmijës për informacion është njohur edhe nga **Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve**, e cila u miratua nga Kombet e Bashkuara në 1989 dhe që atëherë është ratifikuar nga shumica e shteteve. Në të thuhet pa mëdyshje, se ka një të drejtë për lirinë e shprehjes dhe ka liri për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion dhe ide të çdo lloji (neni 13); neni 19 tregon për

---

26 «Të drejtat seksuale janë të lidhura me të drejtat e njeriut që tashmë janë të njohura nga ligjet kombëtare, nga dokumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe deklarata të tjera konsensusi. Ato përfshijnë të drejtën e çdo personi, të çliruar nga detyrimi, diskriminimi dhe dhuna,

- për standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit seksual, duke përfshirë edhe aksesin në kujdesin shëndetësor seksual dhe riprodhues;
- të kërkojë, të marrë dhe të shpërndajë informacion rreth seksualitetit;
- për edukim seksual;
- e respektit për pacënueshmërinë fizike;
- e zgjedhjes së lirë të partnerit;
- të vendosë, nëse do të jetë apo jo seksualisht aktiv;
- për marrëdhënie seksuale konsensuale;
- për lidhje martesë konsensuale;
- të vendosë, nëse do dhe kur dëshiron të ketë fëmijë; dhe
- e përpjekjes për një jetë seksuale të kënaqshme, të sigurt dhe të pëlqyeshme.

Ushtrimi i përgjegjshëm i të drejtave të njeriut kërkon që të gjithë të respektojnë të drejtat e njëri-tjetrit». OBSH (2006), f.10.

---

27 Kombet e Bashkuara (1989).

## Ekskurs i shkurtër: «Intimate Citizenship»

Në këtë kontekst është e udhës të futet termi «Intimate Citizenship», i cili i nënkupton të drejtat seksuale nga një perspektivë e shkencave sociale.

Shkencëtarët e lëmisë sociale dhe seksuale aktualisht po bëjnë thirrje për vendosjen e një morali negociues si moralin seksual të vlefshëm për kohët e tanishme. Thelbi i këtij morali është që të gjitha çështjet e të përfshirëve që janë të moshës madhore, që kanë të njëjtin status, të njëjtat të drejta dhe fuqi, të negociohen me marrëveshje. Një parakusht i rëndësishëm për këtë është që të përfshirët të bien dakort mbi termin «miratim» (consent) dhe të jenë të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre, veçanërisht përsa i përket sjelljes në lidhje dashurore dhe të asaj seksuale.

Nëse mund të supozohet, se ky kusht është përmbushur, atëherë përdoret termi «Intimate Citizenship». Ky është një term sociologjik që përshkruan zbatimin e të drejtave civile në shoqërinë civile. Ai bazohet në parimin e moralit negociues dhe përveç seksualitetit përfshin prirjet seksuale, orientimet seksuale, dukuritë e ndryshme të maskulinitetit dhe feminitetit, forma të ndryshme marrëdhëniesh si dhe forma të bashkëjetesës midis prindërve dhe fëmijëve. Ka pra një ndërthurje të fortë midis termit intimitet dhe pikëpamjes gjithëpërfshirëse ndaj seksualitetit të paraqitur në këto standarde. Prandaj, Intimate Citizenship nënkupton kryesisht barazinë e statusit social dhe ekonomik të individëve që ruajnë pavarësinë e tyre personale dhe në të njëjtën kohë respektojnë kufijtë e të tjerëve.<sup>28</sup>

Kërkesat e Intimate Citizenship ndaj individit pasqyrohen në plan shoqëror tek të drejtat e njeriut dhe ato seksuale. T'i kërkosh këto të drejta nënkupton gjithashtu të respektosh dhe të realizosh në mënyrë të vazhdueshme të drejtën për barazi midis gjinive dhe vetëvendosjen seksuale të individit, i lirë nga detyrimi dhe shfrytëzimi. Kjo kërkesë e forcon individin ndaj ndërhyrjeve të familjes ose shoqërisë. Është e një rëndësie vendimtare, që këto të drejta seksuale të njihen dhe të merren parasysh, nëse ato duhet të kërkohen, nxiten dhe të mbrohen edhe për të tjerët.<sup>29</sup>

Kështu, një politikë qendrore edukative mbi të drejtat seksuale ka për detyrë të theksojë, se në familje, si dhe në institucionet arsimore duhet të përçohen dhe të promovohen aftësi të caktuara të nxënies dhe një mendim kritik. Me anë të tyre, fëmijët dhe të rinjtë – të rriturit e së nesërme – do të arrijnë të zotërojnë sfidat e të vepruarit në mënyrë të pavarur dhe konsensuale gjatë negociatave me të tjerët.

Po ashtu, ata duhet të jenë në gjendje të shprehin dhe të reflektojnë me fjalë ndjenjat, mendimet dhe veprimet e tyre. Një edukim seksual gjithëpërfshirës dhe i përshtatshëm për moshën është veçanërisht i duhur për përcjelljen dhe diskutimin e temave përkatëse, si dhe përvetësimin e aftësive të nevojshme.

28 Plummer (2001), Schmidt (2004), Weeks (1998).

29 OBSH (2006) dhe IPPF (2008), f.10–11.

Kohët e fundit, **IPPF**, organizata kryesore joqeveritare ndërkombëtare në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues, miratoi një «**Deklaratë mbi të drejtat seksuale**».<sup>30</sup> Kjo deklaratë, e cila bazohet kryesisht në të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht, është e strukturuar në një mënyrë të ngjashme me publikimin e mëparshëm gjerësisht të njohur «**Karta e IPPF-së e të drejtave seksuale dhe riprodhuese**».<sup>31</sup> Edhe kjo deklaratë cilëson gjithashtu të drejtën për arsimim dhe informacion.<sup>32</sup>

Në vitin 2008, **World Association for Sexual Health** publikoi një deklaratë mbi shëndetin seksual. Edhe në këtë dokument, të drejtat seksuale konsiderohen të jenë të një rëndësie vendimtare për arritjen e përgjithshme të shëndetit seksual.<sup>33</sup>

Pas rishikimit të përkufizimeve të mësipërme dhe atyre të tjera dhe të udhëhequr nga një qasje gjithëpërfshirëse dhe pozitive mbi të cilën bazohen këto standarde, edukimi seksual në këtë koncept duhet të kuptohet si më poshtë:

**Edukim seksual** do të thotë të mësosh diçka për aspektet kognitive, emocionale, sociale, interaktive dhe fizike të seksualitetit.

Edukimi seksual fillon në fëmijërinë e hershme dhe vazhdon gjatë pubertetit deri në moshë të rritur. Qëllimi i tij kryesor tek fëmijët dhe të rinjtë është nxitja dhe mbrojtja e zhvillimit seksual.

Përmes tij, fëmijët dhe të rinjtë përftojnë hap pas hapi informacion, aftësi dhe vlera pozitive dhe aftësohen që të kuptojnë dhe shijojnë seksualitetin e tyre, të hyjnë në marrëdhënie të sigurta dhe përmëshëse dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj shëndetit të tyre seksual dhe atij të partnerit të tyre.

Ai i aftëson ata që të marrin vendime që pasurojnë cilësinë e jetës së tyre dhe kontribuon në krijimin e një shoqërie të karakterizuar nga dhembshuria (compassion) dhe drejtësia.

Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të marrin një edukim seksual të përshtatshëm për moshën e tyre.

Sipas këtij përkufizimi, fokusi kryesor është tek seksualiteti si një potencial pozitiv i njeriut dhe një burim përmëshëje dhe kënaqësie. Domosdoshmëria e njohur përgjithësisht për të ditur dhe për të qenë i aftë për të shmangur sëmundjet seksualisht të transmetueshme është në plan të dytë në këtë qasje pozitive. Përveç kësaj, të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht duhet të formojnë bazën për edukimin seksual. Kjo vlen veçanërisht për të drejtën për informacion, e cila ka përparësi ndaj parandalimit të sëmundjeve.

---

30 IPPF (2008).

31 IPPF (1996).

32 IPPF (2008).

33 World Association for Sexual Health (2008).



## Përkufizime të tjera nga UNESCO dhe IPPF për edukimin seksual

«Comprehensive sexuality education seeks to equip young people with the knowledge, skills, attitudes and values they need to determine and enjoy their sexuality – physically and emotionally, individually and in relationships. It views «sexuality» holistically and within the context of emotional and social development. It recognizes that information alone is not enough. Young people need to be given the opportunity to acquire essential life skills and develop positive attitudes and values.»<sup>34</sup>

Tek «International Technical Guidance on Sexuality Education», të përpiluar së fundmi nga UNESCO dhe organizata të tjera të Kombeve të Bashkuara, edukimi seksual përshkruhet si më poshtë:

«Sexuality Education is defined as an age-appropriate, culturally relevant approach to teaching about sex and relationships by providing scientifically accurate, realistic, nonjudgemental information. Sexuality Education provides opportunities to explore one's own values and attitudes and to build decision-making, communication and risk-reduction skills about many aspects of sexuality.»<sup>35</sup>

34 «Edukimi gjithëpërfshirës seksual i pajis të rinjtë me njohuritë dhe aftësitë bazë, sjelljet dhe vlerat që u duhen për të përcaktuar dhe shijuar seksualitetin e tyre fizikisht dhe emocionalisht, vetëm dhe brenda marrëdhënieve. Ai e konsideron seksualitetin si gjithëpërfshirës dhe e vëzhgon atë në kontekstin e zhvillimit emocional dhe social. Ai merr parasysh faktin se vetëm thjesht informacioni nuk është i mjaftueshëm. Të rinjve duhet t'u jepet mundësia të mësojnë aftësi bazë dhe të zhvillojnë qëndrime dhe vlera pozitive.» IPPF (2006b), f. 6.

35 «Edukimi seksual përkufizohet si një qasje ndaj seksualitetit dhe marrëdhënieve, e përshtatshme për moshën dhe në përputhje me kulturën përkatëse, duke dhënë informacion shkencërisht të saktë, realist dhe të paanshëm. Edukimi seksual mundëson rishqyrtimin e vlerave dhe qëndrimeve vetjake dhe mëson aftësi për vendimmarrje, komunikim dhe zvogëlim të rrezikut për shumë aspekte të seksualitetit.» UNESCO (2009b), f. 2.

## 3. Parimet themelore të edukimit seksual

### 3.1 Reflektime bazë mbi edukimin seksual

#### Seksualiteti si një element qendror i identitetit njerëzor

Të gjitha qeniet njerëzore lindin si qenie seksuale dhe duhet ta zhvillojnë potencialin e tyre seksual në një formë ose në një tjetër. Edukimi seksual ndihmon në përgatitjen e të rinjve për jetën, veçanërisht në lidhje me krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të kënaqshme, dhe nxit vetëvendosjen dhe zhvillimin personal pozitiv.

#### Njerëzit kanë të drejtë për informacion

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve<sup>36</sup> cilësohet qartë e drejta për informacion si dhe detyrimi i shtetit për të siguruar masa edukative për fëmijët.

Të drejtat seksuale, si të drejta të njeriut përsa i përket seksualitetit, ofrojnë një kornizë shtesë që përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e edukimit seksual. Neni 8 i Deklaratës së IPPF-së thotë: «Right to education and information: All persons, without discrimination, have the right to education and information generally and to comprehensive sexuality education and information necessary and useful to exercise full citizenship and equality in the private, public and political domain.»<sup>37</sup>

Të drejtat e njeriut janë parimi udhëheqës i publikuar nga OBSH-ja tek «Reproductive health strategy to accelerate progress towards the attainment of international development goals and targets.»<sup>38</sup> Promovimi i shëndetit seksual është aty një ndër pesë temat kryesore.

Edhe World Association for Sexual Health i sheh të drejtat seksuale si pjesë përbërëse e të drejtave themelore të njeriut dhe kështu si të patjetërsueshme dhe universale.<sup>39</sup> Në publikimin e saj më të fundit të titulluar «Sexual Health for the Millennium»,<sup>40</sup> ajo shpreh idenë se shëndeti seksual duhet të promovohet si një strategji qendrore për arritjen e objektivave të zhvillimit për mijëvjeçarin (Millennium Development Goals = MDG). Në këtë kontekst janë formuluar tetë synime. I katërti nga këto synime parashikon mundësinë universale për të pasur edukim dhe informacion seksual gjithëpërfshirës. Shëndeti seksual mund të arrihet vetëm nëse të gjithë njerëzit, duke përfshirë edhe të rinjtë, gjatë gjithë jetës së tyre, kanë mundësi për të pasur një edukim seksual gjithëpërfshirës, të marrin informacion rreth shëndetit seksual dhe kujdes shëndetësor seksual.<sup>41</sup> Siç tregojnë rezultatet e hulumtimeve, shqetësimi, se të rinjtë përmes edukimit seksual bëhen më shpesh ose më herët aktivë seksualisht, është i pabazuar.<sup>42</sup>

#### Për një shoqëri moderne, vetëm edukimi seksual jashtëshkollor nuk është i mjaftueshëm

Siç u parashtrua më herët, prindërit, anëtarët e tjerë të familjes dhe burimet jashtëshkollore luajnë një rol të rëndësishëm në mësimin e marrëdhënieve njerëzore dhe seksualitetit, veçanërisht për grupmoshat më të reja. Megjithatë, në shoqërinë moderne shpesh kjo nuk është e mjaftueshme, pasi këta këshilltarë jashtë shkollës shpesh nuk kanë vetë njohuritë e nevojshme, veçanërisht kur kërkohet informacion kompleks dhe ekspert, siç janë pyetjet në lidhje me mbrojtjen dhe rrugët e transmetimit të STI-ve. Përveç kësaj, të rinjtë

36 Kombet e Bashkuara (1989).

37 «E drejta për arsimim dhe informacion: Të gjithë njerëzit kanë të drejtën themelore dhe të barabartë për arsimim dhe informacion, si dhe për edukim dhe informacion seksual gjithëpërfshirës, të cilat janë të nevojshme dhe të dobishme për të qenë në gjendje për të ushtruar të drejtat e plota civile dhe barazinë në sferën private, publike dhe politike.» IPPF (2008), shih edhe kapitullin 2.

38 OBSH (2004), f.21

39 World Association for Sexual Health (1999).

40 Shih World Association for Sexual Health (2008), fq.2.

41 World Association for Sexual Health (2008), fq.4–5.

42 Përmbledhja e rezultateve të hulumtimeve të gjendura në raportin e UNESCO-s (2009a) (vëll. 1, fq. 13–17) tregojnë qartë se, sipas shumicës së studimeve, edukimi seksual priret të vonojë kohën e marrëdhënieve të para seksuale, të ulë shpeshtësinë e kontakteve seksuale dhe numrin e partnerëve seksualë dhe të përmirësojë sjelljen seksuale parandaluese.

duke filluar që nga puberteti shpesh preferojnë të përdorin burime të tjera informacioni dhe njerëz që nuk janë aq të afërt me ta, sesa prindërit e tyre.

### Të rinjtë përdorin shumë burime moderne të informacionit

Mediat moderne, veçanërisht telefonat celularë dhe interneti, brenda një kohe shumë të shkurtër janë shndërruar në burime të rëndësishme informacioni. Megjithatë, veçanërisht përsa i përket seksualitetit, ato shpesh japin informacion të shtrembëruar, të papeshuar, jorealit dhe shpesh përcmues, veçanërisht ndaj grave, siç është rasti i pornografisë në internet. Si rezultat, një detyrë e re për edukimin seksual ka sjellë nevojën për të kundërvepruar ndaj informacioneve dhe imazheve mashtruese të transmetuara nga mediat dhe t'i korigjojë ato.

### Domosdoshmëria e promovimit të shëndetit seksual

Përgjatë historisë njerëzore, seksualiteti është parë edhe si një kërcënim për shëndetin e njeriut, pasi sëmundjet e pashërueshme seksualisht të transmetueshme dhe shtatzënitë e padëshiruara pothuajse gjithmonë paraqesnin rreziqe të mëdha për sa i përket kontakteve seksuale. Në shekullin 21-të, këto dhe rreziqe të tjera shëndetësore mund të shmangen, jo vetëm sepse tani janë njohuritë e nevojshme, por edhe sepse seksualiteti nuk është më një temë tabu dhe prandaj është i hapur për diskutim nga pikëpamja parandaluese. Edukimi seksual i shërben promovimit urgjentisht të nevojshëm të shëndetit seksual.

Shëndeti seksual dhe riprodhues vlerësohet sot shumë në të gjithë botën. Tre nga objektivat e zhvillimit për mijëvjeçarin të njohura ndërkombëtarisht (MGD 3 – barazia gjinore, MGD 5 – kujdesi shëndetësor për nënat, MGD 6 – përfshirë HIV/SIDA) kanë lidhje drejtpërdrejt me këtë tematikë. Edukimi seksual mund të japë një kontribut të rëndësishëm në arritjen e këtyre qëllimeve universale të zhvillimit.

## 3.2 Zhvillimi psikoseksual i fëmijëve

Në këtë pjesë trajtohet, pse edukimi seksual duhet të fillojë që në fëmijërinë e hershme dhe pse tema të caktuara prezantohen në moshë të caktuar. Institucioni belg SENSOA dhe Rutgers Nisso Group nga Holanda, dy organizata të njohura në fushën e edukimit seksual, janë treguar bujarë duke na vënë në dispozicion përmbledhje ekzistuese, të cilat për këtë botim janë shkurtuar dhe përshtatur paksa.<sup>43</sup> Literatura shkencore në të cilën bazohet kjo pjesë është e listuar tek bibliografia, pjesa B.

Psikologjia, veçanërisht psikologjia e zhvillimit, ka treguar se fëmijët lindin si qenie seksuale dhe se zhvillimi i tyre seksual kryhet në shumë faza, të cilat janë të ndërlidhura me zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës dhe sfidat e zhvillimit që kanë të bëjnë me të. Këto faza të zhvillimit seksual do të parashtrihen në mënyrë të detajuar për të shpjeguar dhe treguar domosdoshmërinë e përmendur tashmë për një edukim të hershëm seksual, dhe se tema ose informacione të caktuara, aftësi dhe qëndrime të caktuara duhet të përcillen në varësi të përparimit të zhvillimit të fëmijës. Nëse është e mundur, temat përkatëse duhet të trajtohen para se fëmija të arrijë fazën përkatëse të zhvillimit, në mënyrë që të jetë i përgatitur për ndryshimet që do të vijnë. (Për shembull, një vajzë duhet të dijë rreth menstruacioneve para se t'i vijnë zakonet e para).

Kur bëhet fjalë për temën e sjelljes seksuale të fëmijëve dhe të rinjve, duhet të jemi të vetëdijshëm se seksualiteti fëmijor ndryshon nga seksualiteti i të rriturve, dhe se të rriturit nuk duhet të nisen nga perspektiva e tyre kur gjykojnë sjelljen seksuale të fëmijëve dhe të rinjve.

Kur interpretojnë mënyrat e sjelljes nga pikëpamja seksuale, të rriturit i bazojnë ato tek përvojat e tyre si të rritur dhe shpesh e kanë të vështirë t'i shohin gjërat me sytë e një fëmije. Porse është jashtëzakonisht e rëndësishme që gjërat të shihen nga perspektiva e tyre.

43 Krh. Rutgers Nisso Groep (2008) dhe Frans E. & Franck T (2010).

Njeriu luan një rol të rëndësishëm dhe aktiv në procesin e vetë të zhvillimit, i cili kryhet në faza të ndryshme të jetës. Për të rinjtë, integrimi i seksualitetit në fusha të tjera të personalitetit të tyre, të tilla si zhvillimi i vetëvlerësimit, i aftësisë për të krijuar lidhje dhe për të qëndruar në lidhje, është një detyrë e rëndësishme. Tek të gjitha ndryshimet që ndodhin gjatë zhvillimit seksual ndikojnë edhe faktorë biologjikë, psikologjikë dhe socialë. Bazuar në përvojat e tyre, njerëzit krijojnë një ide se ç'loj sjelljeje seksuale (p.sh. koha e marrëdhënive të para seksuale dhe zgjedhja e partnerit/partneres) është «e përshtatshme», ç'pasoja dhe reagime janë të pritshme dhe si duhet të gjykojnë këto.

Zhvillimi i sjelljes seksuale, i ndjenjave dhe aftësisë menduese, fillon që në barkun e nënës dhe vazhdon gjatë gjithë jetës së njeriut. Faza të hershme të perceptimit të mëvonshëm seksual, siç është aftësia për të shijuar kontaktin fizik, janë të pranishme që në lindje. Zhvillimi seksual dhe personal i njeriut karakterizohet veçanërisht nga katër fusha qendrore përvojash, të cilat përjetojnë në një moshë shumë të hershme: Përvoja me nevojat vetjake, me trupin, me marrëdhëniet dhe me seksualitetin. A ka mundur fëmija të krijojë një ndjenjë besimi bazë, se ka dikë që ia shuan urinë dhe etjen dhe se i jep afërsi dhe ngrohtësi fizike? A i janë konfirmuar dhe pranuar ndjenjat e tij? Ç'përvojë mësimi ka fituar nga marrëdhëniet e tij me prindërit dhe vëllezërit e motrat? Çfarë përvojash ka mundur të grumbullojë? A ka mësuar të ndihet mirë në trupin e vet, ta dojë dhe të kujdeset për të? A e kanë pranuar fëmijën ashtu siç është, si vajzë apo djalë? Të gjitha këto përvoja nuk janë përvoja seksuale në kuptimin e ngushtë të fjalës, por ato janë të një rëndësie qendrore për zhvillimin e karakterit dhe zhvillimin seksual të njeriut.

Sjellja seksuale tek fëmijët dhe adoleshentët zakonisht krijohet individualisht ose midis bashkëmoshatarëve, si lojë ose ngacim, si një mundësi për të zbuluar veten dhe të tjerët. Në këtë mënyrë fëmijët dhe të rinjtë zbulojnë se çfarë u pëlqen dhe çfarë jo; ata mësojnë si të sillen me intimitetin, si dhe me rregullat e sjelljes nëpër situata seksuale. Në mënyrë të ngjashme lindin edhe normat dhe vlerat e tyre në lidhje me seksualitetin.

Që në fëmijërinë e hershme, prindërit, edukatorët e tjerë dhe mediat përcjellin një larmi vlerash dhe normash të sjelljes (me specifike gjinore ose të tjera). Në çdo fazë të jetës, seksualiteti shprehet në mënyrë të ndryshme dhe merr një kuptim të ri.

Zhvillimi i aftësive efektive për të hyrë në kontakt me të tjerët është thelbësor për jetën seksuale të njeriut dhe është i ndikuar shumë nga historia e tij personale. Historia familjare, marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, edukimi seksual, autoerotizmi dhe përvojat e para seksuale – të gjitha këto ndikojnë në perceptimin seksual, ndjenjat seksuale, motivimet, qëndrimet dhe aftësinë për të hyrë në ndërveprim me të tjerët.

Këto përvoja i shërbejnë një qëllimi specifik: Ato krijojnë një kornizë për të kuptuar ndjenjat dhe sjelljet vetjake dhe për të kuptuar sjelljet e të tjerëve. Për më tepër, fëmijët dhe të rinjtë mësojnë diçka edhe në lidhje me vendosjen e kufijve.

Për shkak të larmisë së opinioneve rreth seksualitetit, ka një tendencë më të theksuar për preferenca dhe vendime individuale. Për më tepër, pjekuria biologjike në kohët e sotme, fillon më herët dhe seksualiteti është shumë më i pranishëm nëpër media dhe në kulturën e të rinjve. Kjo do të thotë që specialistët pedagogjikë dhe prindërit duhet të përpiqen më shumë për të mbështetur fëmijët dhe të rinjtë në mënyrën si e përjetojnë ata zhvillimin e tyre seksual.

### **Procesi i zhvillimit seksual Dhjetë vitet e para**

Në përgjithësi, fëmijët brenda gjashtë viteve të para dalin shpejt nga varësia totale dhe fitojnë një pavarësi të kufizuar. Ata ndërjegjësohen për trupin e vet. Fëmijët kanë madje edhe në moshë të hershme ndjenja seksuale. Midis moshës dy dhe tre vjeç, ata zbulojnë dallimet fizike midis mashkullit dhe femrës. Gjatë kësaj kohe, fëmijët fillojnë të zbulojnë trupin e vet (masturbimin foshnjor, vetëstimulimin) dhe ndoshta duan të ekzaminonjë trupat e miqve të tyre (lojëra doktorësh). Fëmijët fitojnë njohuri për mjedisin e tyre duke provuar, dhe seksualiteti nuk bën dallim në këtë drejtim nga fushat e tjera. Studime të shumta vëzhguese

kanë treguar, se interesi dhe sjelljet seksuale janë të zakonshme tek fëmijët dhe se këto sjellje duhet të konsiderohen si normale.

Duke eksploruar ndjenjat dhe dëshirat seksuale, si dhe duke bërë pyetje, fëmijët mësojnë gjithnjë e më shumë për seksualitetin. Duke filluar nga moshë tre vjeç, ata e kuptojnë se të rriturit e mbajnë atë sekret. Ata masin kufijtë e të rriturve duke u zhveshur pa paralajmërim ose duke përdorur gjuhë me nuanca seksuale. Fëmijët e vegjël janë jashtëzakonisht kuriozë dhe bëjnë shumë pyetje. Ata gradualisht e humbasin egoizmin e tyre dhe janë gjithnjë e më shumë në gjendje ta vënë veten në vendin e të tjerëve. Ndërsa zhvillimi i gjuhës së folur përparon, kontakti fizik kalon disi në plan dytësor. Në këtë fazë, fëmijët zotërojnë shumë mundësi për t'u shprehur. Fëmijët më të mëdhenj zhvillojnë gradualisht ndjenjën e turpits, ku koha e shfaqjes dhe forma e tij ndryshojnë në varësi të situatës së tyre familjare.

Rreth moshës gjashtë vjeç, fëmijët vazhdojnë të jenë akoma shumë kureshtarë, por e vërejnë se shumë të rritur nuk u përgjigjen më pyetjeve të tyre aq hapur sa ç'thonë. Për të mësuar më shumë, ata u drejtohen bashkëmohatarëve të tyre. Fëmijët në moshën e shkollës fillore bëhen më introvertë dhe gjatë zhvillimit të tyre moral, tek ta vjen e rritet një ndjenjë turpi ndaj seksualitetit të tyre. Tek një e treta e djemve tetëvjeçarë janë vënë re lojëra seksuale, ku përqindja e tyre rritet gradualisht me moshën. Sasia e «aktivitetit seksual» midis vajzave është shumë më e ulët, por me rritjen e moshës interesi seksual rritet edhe tek ato. Fëmijët e moshës pesë vjeç e sipër dhe veçanërisht midis shtatë dhe tetë vjeç kanë qejf të tregojnë organet e tyre gjenitale dhe gjithashtu dëshirojnë të shikojnë ato të fëmijëve të tjerë. Motivi i tyre kryesor është kurioziteti dhe etja për dije. Seksualiteti i fëmijëve është shumë më i larmishëm se ai i një të rrituri mesatar. Mund të shihet si një aspekt i zhvillimit shqisor që është pjesë e zhvillimit psikologjik, social dhe biologjik.

### **Zhvendosja e interesit tek fëmijët para pubertetit dhe zhvillimi seksual gjatë pubertetit**

Midis moshës njëmbëdhjetë dhe trembëdhjetë vjeç, interesi i fëmijëve para moshës madhore zhvendoset, pasi për ta gjithnjë e më rëndësi kanë

njohuritë e hollësishme për trupin dhe organet seksuale, veçanërisht për ato të gjinisë së kundërt. Gjatë pubertetit, identitetit social i shtohet edhe kërkimi i identitetit psikik. Të rinjtë fillojnë të mendojnë për vlerat e tyre të brendshme, kuptimin e tyre dhe vendin e tyre në botë. Formimi i identitetit është i lidhur ngushtë me imazhin për veten. Puberteti pra është koha kur të rinjtë zgjerojnë aftësitë e tyre intelektuale dhe zhvillohen moralisht.

Gjatë pubertetit, zhvillimi seksual përshpejtohet. Perceptimet dhe motivet për sa i takon seksualitetin marrin një dimension shoqëror përmes rëndësisë dhe ndikimit më të madh nga njerëzit e tjerë. Edhe procesi i pjekurisë seksuale është po ashtu në aktivitet të plotë. Dallimet midis djemve dhe vajzave bëhen më të qarta. Shoqet dhe shokët e së njëjtës gjini janë të rëndësishëm si partnerë bisede në fazat e hershme të pubertetit, po ashtu nisin edhe përpjekjet e para për t'u afruar me gjininë e kundërt. Gjatë pubertetit, lind një mospërputhje midis zhvillimit fizik dhe gjendjes shpirtërore.

Në këtë pikë të jetës së tyre të rinjtë kalojnë një periudhë intensive reflektimi. Ata mësojnë dalëngadalë të mendojnë për gjëra dhe ngjarje të paperceptueshme, të cilat nuk i kanë përjetuar personalisht. Edhe introspeksioni bëhet po ashtu i mundur. Gjithashtu, të rinjtë zhvillojnë aftësinë për të bashkuar karakteristikat individuale në një njësi të vetme, që u mundëson atyre të mendojnë drejt synimit të zgjidhjes.

Midis moshës 12 dhe 20 vjeç, adoleshentët zhvillojnë gradualisht orientimin e tyre seksual. Në të njëjtën kohë, prirjet e tyre seksuale formohen dhe konsolidohen.

Për të pasur një ide më të qartë të fazave individuale të zhvillimit, në të cilat bazohet përmbledhja mbi edukimin seksual në pjesën II të këtij dokumenti, prezantimi i mëposhtëm është përfshirë në formë tabelare dhe përmbledh tematikën e lartpërmendur.

### Faza 1: 0 deri në 3 vjeç

Zbulim dhe eksplorim

**Foshnjat:** 0 dhe 1 vjeç (zbulim)

- Zhvillimi seksual i fëmijëve fillon që nga **lindja**.
- Foshnjat përqendrohen tërësisht tek **shqisat** e tyre duke prekur, dëgjuar, shikuar, shijuar dhe nuhatur. Përmes shqisave të tyre, foshnjat mund të përjetojnë një ndjenjë të rehatisë dhe sigurisë. Është shumë e rëndësishme, ta lehtësohet foshnjën dhe të **përqafohesh** me të, pasi përmes tyre hidhen themelet për zhvillimin e tij të shëndoshë social dhe emocional.
- Foshnjat janë të zëna me zbulimin e botës përreth tyre. Kjo tregohet tek prireja e tyre për të futur lodra në gojë (prekja), për të vëzhguar fytyra ose mobilet që lëvizin (shikimi) dhe për të dëgjuar muzikë (dëgjimi). Foshnjat zbulojnë gjithashtu edhe trupin e tyre. Ata shpesh prekin veten, ndonjëherë edhe **organet** e tyre **gjenitale**. Megjithatë, kjo ndodh më shumë rastësisht sesa me qëllim.

**Fëmijët e vegjël:** 2 dhe 3 vjeç (kuriozitet, eksplorim i trupit)

- Fëmijët e vegjël bëhen të **vetëdijshëm** për veten dhe për **trupin e tyre**. Ata mësojnë gjithashtu se ata kanë pamje të ndryshme nga fëmijët dhe të rriturit e tjerë (zhvillimi i identitetit).
- Fëmijët e vegjël mësojnë se janë **djem ose vajza** (zhvillimi i identitetit gjinor).
- Fëmijët e vegjël kanë një **interes** gjithnjë e më të madh për **trupin e tyre**. dhe atë të njerëzve përreth tyre. Shpesh, ata ekzaminojnë imtësisht trupin dhe organet e tyre gjenitale dhe ua tregojnë ato fëmijëve dhe të rriturve të tjerë.
- Fëmijët e vegjël prekin me dashje **organet** e tyre **gjenitale** sepse ndihen mirë kur e bëjnë.
- Fëmijët e vegjël kanë ende një nevojë të madhe për **kontakt fizik**. Atyre u pëlqen të rrinë në prehër dhe iu pëlqen shumë të përqafohen.
- Dalëngadalë ata mësojnë gjithashtu **çka është e lejuar dhe çka jo** (normat shoqërore).

### Faza 2: 4 deri 6 vjeç

Mësimi i rregullave, loja dhe krijimi i shoqërive

- Fëmijët kanë më shpesh kontakte me grupe të mëdha (në kopsht dhe shkollë). Ata **mësojnë** gjithnjë e më tepër, se si **«duhet» të sillen** (rregullat shoqërore).
- Ata mësojnë, se të rriturit **nuk e shohin me sy të mirë**, nëse ata zhvishen në publik dhe prekin veten ose të tjerët. Prandaj ka më pak gjasa, që ata të sillen lakuriq në publik dhe të prekin organet e tyre gjenitale.
- Eksplorimi i trupit të vet dhe i atij të njerëzve të tjerë shprehet më shumë **në formë loje** (lojëra seksuale). Fëmijët luajnë «babi dhe mami», po ashtu edhe lojëra doktorësh, fillimisht hapur, më vonë shpesh fshehurazi, pasi mësojnë se lakuriqësia nuk lejohet në publik.
- **«Faza e fjalëve të pista»:** Fëmijët zbulojnë kufijtë e tyre. Ata e vënë re, se njerëzit përreth tyre reagojnë kur thuhet fjalë të caktuara. Meqenëse kjo është interesante dhe gazmore, ata i përsërisin këto fjalë.
- Në këtë moshë fëmijët janë shumë të interesuar për **riprodhimin** dhe bëjnë pyetje pafund si: «Prej nga vijnë fëmijët e vegjël?»
- Shumica e fëmijëve zhvillojnë një ndjenjë turpi për trupin e tyre dhe fillojnë të distancohen.
- Fëmijët e dinë që ata janë **djem ose vajza** dhe do të mbeten gjithmonë të tillë.
- Ata zhvillojnë ide të qarta rreth asaj, se «çfarë bën një djalë» dhe «çfarë bën një vajzë» (**rolet gjinore**).
- Fëmijët krijojnë **shoqëri** me fëmijë të tjerë të të dy gjinive, ndonjëherë vetëm me fëmijë të gjinisë së tyre.
- Fëmijët e kësaj moshe, shoqërinë dhe ndjenjën se dikush iu pëlqen, e lidhin me **«rëniën në dashuri»**. Kështu ata shpesh thonë, se janë të dashuruar me nënën e tyre, mësuesin ose lepurin e tyre. Zakonisht kjo nuk ka të bëjë fare

me ndjenjat ose dëshirat seksuale. Është thjesht mënyra e tyre për të thënë, se dikush iu pëlqen shumë.

### Faza 3: 7 deri 9 vjeç

Turpi dhe dashuria e parë

- Fëmijët gradualisht **fillojnë të mos ndihen mirë kur janë lakuriq në praninë e njerëzve të tjerë**. Ata nuk duan të zhvishen më në prani të të rriturve dhe nuk sillen më lakuriq vërdallë.
- Fëmijët bëjnë **më pak pyetje** mbi temën e seksualitetit, por kjo nuk do të thotë se ata janë më pak të interesuar për të. Ata e kanë vënë re, se seksualiteti është një temë «ngarkuar» emocionalisht dhe se është e papërshtatshme të flitet për të në publik.
- Fëmijët e lënë të lirë **fantazinë** e tyre dhe si burim iu shërben ambjenti përreth (familja, shkolla, televizioni, etj.). Fantazia dhe realiteti shpesh ndërthuren me njëri-tjetrin. Për shembull, tema e «dashurisë» mund të jetë objekt i fantazive të tyre, por edhe rënia në dashuri me dikë të së njëjtës gjini.
- Formohen **grupe djemsh dhe vajzash** që «vëzhgojnë» njëri-tjetrin. Djemtë shpesh i shohin vajzat si «budallaqe» dhe «fëminore», ndërsa vajzave iu duken djemtë shpesh si «shumë të vrazhdë» dhe «të zhurmshëm».
- Në situata grupi (klasë, miq), shpesh për ta ka shumë rëndësi të tregojnë, se sa të rritur, të fortë dhe të zgjuar janë. Fëmijët përpiqen t'ia **kalojnë** njëri-tjetrit. Ata duan të tregojnë, se e dinë ç'është bota e fëmijëve më të mëdhenj dhe e të rriturve. Ndër të tjera, kjo shprehet në faktin, se ata tregojnë, sa shumë dinë për seksualitetin, për shembull duke përdorur gjuhë të pasur seksuale. Fëmijët shpikën vjersha me fjalë seksuale dhe tregojnë barcalalet me përmbajtje seksuale (barcalalet të pista), shpesh pa ia ditur kuptimin.
- Në këtë moshë fëmijët gjithashtu përjetojnë **ndjenjat e para** të të qenit të dashuruar.

### Faza 4: 10 deri në 15 vjeç

Faza para pubertetit dhe puberteti

**10 dhe 11 vjeç:** Faza para pubertetit

- **Puberteti po fillon.** Hormonet seksuale nisin të aktivizohen, gjë që shfaqet në sjellje dhe në zhvillimin fizik, por edhe në perceptim dhe ndryshimet e humorit. Puberteti tek vajzat fillon zakonisht dy vjet më herët sesa tek djemtë. Ndryshimet fizike shihen më qartë në formimin e gjinjve dhe në rritjen e madhësisë së trupit.
- Duke filluar nga mosha dhjetë vjeç fëmijët **interesohe**n gjithnjë e më shumë **për seksualitetin e të rriturve**. Ata zhvillojnë fantazi më të forta për seksualitetin, dëgjojnë dhe shohin gjithëfarë lloj gjërash nëpër libra, në televizor dhe në internet që ngjallin kuriozitetin e tyre. Por, nëse u flet për temën e seksualitetit, përgjigja e tyre mund të jetë e turpshme ose shmangëse.
- Në këtë fazë mund të ndodhë **afrimi i parë ndaj dashurisë**: Të rinjtë tani dalin së bashku dhe bëjnë hapa të kujdesshëm drejt njëri-tjetrit (kapen për dore, puthje në faqe, etj.).

**12 deri në 15 vjeç:** Puberteti

- Tani edhe tek shumica e djemve fillon **puberteti**. Testikujt dhe penisi fillojnë të rriten; e njëjta gjë vlen edhe për qimet nën sqetulla dhe në organet gjenitale. Vrulli i rritjes ka nisur. Zëri trashohet dhe mjekra fillon të rritet. (Mesatarisht) djemtë kanë ejakulimin e tyre të parë në moshën 13 vjeç, çka është një shenjë e pjekurisë seksuale dhe aftësisë së tyre riprodhuese.
- Edhe vajzat vazhdojnë të zhvillohen. Ato kanë kaluar tashmë një rritje të shpejtë dhe tani fillon rritja e qimeve nën sqetull dhe në organet gjenitale. Vajzave iu vjen **perioda** e parë (mesatarisht) në moshën dymbëdhjetë vjeç, çka është një shenjë se ato janë pjekur seksualisht dhe mund të mbeten shtatzënë.
- **Masturbimi** tenton të shtohet – më shumë tek djemtë sesa tek vajzat.

- Të rinjtë mund të ndihen shumë **të pasigurt** për sa i përket rritjes së tyre fizike: «A është normale?» «A po zhvillohem shumë ngadalë në krahasim me të tjerët?»
- Të rinjtë së pari duhet të **të mësohen me «trupin e tyre të ri»**, shpesh janë të hutuar dhe nuk ndihen mirë.
- Të rinjtë zhvillojnë një imazh për veten **me ngjyrim seksual**: Ata e shohin veten si një person që mund të ketë marrëdhënie seksuale, prandaj për ta është e rëndësishme që të jenë tërheqës. Meqenëse ata ndihen shpesh të pasigurt për trupin e tyre, shpesh edhe ndihen po aq të pasigurt nëse janë tërheqës për një partnere/partner të mundshëm.
- Për të rinjtë e kësaj moshe shpesh **mendimi i të tjerëve** ka shumë rëndësi për ta. Ata ndikohen lehtë nga bashkëmoshatarët e tyre.
- Gjithashtu njerëzit e së njëjtës moshë iu duken **tërheqës nga ana seksuale**.
- Djemtë dhe vajzat gradualisht zbulojnë nëse i tërheqin djemtë apo vajzat (**orientimi seksual**).
- Ata **bien në dashuri** për herë të parë prej vërteti në jetën e tyre.
- Ata **flirtojnë** me njëri -tjetrin dhe kanë lidhjet e tyre të para.
- Këto pasohen nga përvoja të tjera me **puthje, përkëdhelje dhe petting**.
- Ata **eksperimentojnë** me lidhjet.
- Ata mbledhin **përvoja seksuale** përmes puthjeve dhe petting-ut, disa më herët, disa më vonë.
- **Përvojat seksuale** të të rinjve zakonisht kanë rrjedhën e mëposhtme: Puthje, prekje dhe përkëdhelje me rroba veshur, petting zhveshur, marrëdhënie seksuale (heteroseksualët) dhe së fundmi seks oral dhe nganjëherë anal.
- Ata fitojnë më shumë përvojë në lidhje me gjininë e kundërt: Tema shumë të rëndësishme janë negociimi, komunikimi dhe formulimi i **dëshirave dhe i kufijve** dhe krijimi i respektit.

#### Faza 5: 16 deri në 18 vjeç

Në pragun e moshës madhore

- Të rinjtë bëhen **më të pavarur** dhe nuk janë më aq fort të lidhur pas prindërve të tyre.
- Tani ata e kanë të qartë për veten e tyre, nëse janë **heteroseksualë apo homoseksualë**.



## 4. Parimet dhe qëllimet e edukimit seksual

Një edukim i përgjithshëm seksual bazohet në **parimet** e mëposhtme:

1. Edukimi seksual është i përshtatshëm për moshën sa i takon nivelit të zhvillimit dhe njohurive të rinjve dhe merr parasysh faktorët kulturorë, socialë dhe specifikë gjinorë. Ai përkon me realitetin e jetës së rinjve.
2. Edukimi seksual bazohet në një qasje që orientohet për nga të drejtat (seksuale dhe riprodhuese) të njeriut.
3. Edukimi seksual bazohet në një koncept gjithëpërfshirës të mirëqenies që përfshin edhe shëndetin.
4. Edukimi seksual është i orientuar qartë drejt barazisë gjinore, vetëvendosjes dhe pranimin të diversitetit.
5. Edukimi seksual fillon që nga lindja.
6. Edukimi seksual duhet kuptuar si aftësim i individëve dhe bashkësive dhe kështu si një kontribut për një shoqëri të karakterizuar nga dhembshuria dhe drejtësia.
7. Edukimi seksual bazohet në informacione shkencore të sakta.

Edukimi seksual ka për synim këto **qëllime**:

1. Ai kontribuon për një klimë shoqërore që karakterizohet nga toleranca, respekti dhe të qenit i hapur ndaj seksualitetit, stileve të ndryshme të jetesës, qëndrimeve dhe vlerave.
2. Ai nxit respektimin e larmisë dhe dallimit të gjinive, si dhe ndërgjegjësimin për identitetin seksual dhe rolet gjinore.
3. Ai i aftëson njerëzit të marrin vendime të informuara dhe në bazë të tyre të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe me përgjegjësi.
4. Ai kontribuon në ndërgjegjësimin për trupin e njeriut dhe të njohurive të mira rreth zhvillimit dhe funksioneve të tij, veçanërisht në lidhje me seksualitetin.
5. Ai i aftëson njerëzit që të zhvillohen si qenie seksuale. Kjo do të thotë, të mësosh të shprehësh ndjenjat dhe nevojat, të përjetosh kënaqësi nga seksualiteti si dhe të zhvillosh rolin gjinor dhe identitetin seksual vetjak.
6. Ai jep informacione të duhura në lidhje me aspektet fizike, kognitive, sociale, emocionale dhe kulturore të seksualitetit, në lidhje me masat mbrojtëse dhe parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, HIV-it dhe abuzimin seksual.
7. Ai tregon aftësitë e nevojshme jetësore, për të përballur të gjitha aspektet e seksualitetit dhe lidhjeve dashurore.
8. Ai shpërndan informacion se ku mund të merret këshillim dhe shërbime mjekësore, veçanërisht kur bëhet fjalë për probleme dhe pyetje në lidhje me seksualitetin.
9. Ajo nxit një reflektim mbi seksualitetin dhe normat e vlerat e ndryshme për sa i përket të drejtave të njeriut, në mënyrë që secili të krijojë qëndrime kritike individuale.
10. Ai ndihmon në aftësinë për të ndërtuar lidhje dashurore (seksuale) që karakterizohen nga mirëkuptimi dhe respekti i ndërsjelltë ndaj nevojave dhe kufijve të partnerit, dhe për të patur lidhje me të drejta të barabarta. Kjo mund të ndihmojë në parandalimin e abuzimit dhe dhunës seksuale.
11. Ai jep aftësinë për të komunikuar rreth seksualitetit, emocioneve dhe lidhjeve dhe ndihmon zhvillimin e aftësive të nevojshme gjuhësore për t'i shprehur ato.

## 5. Grupet e synuara dhe partnerët e edukimit seksual

Grupet e synuara dhe partnerët e edukimit seksual mund të ndryshojnë dhe shpesh mund të jenë edhe të njëjtët. Një shembull për këtë janë vetë të rinjtë: Të rinjtë shpesh shihen vetëm si grupi kryesor i synuar, por shpesh anashkalohet fakti, se ata janë po aq partnerë me ndikim të fortë, ashtu siç ka treguar përvoja me «Peer Education».

### **Edukimi seksual është një proces i përjetshëm**

Edukimi seksual është një proces i përjetshëm dhe më i rëndësishëm ai është në fëmijëri dhe adoleshencë. Ai duhet të jetë i përshtatshëm për grupmosha të ndryshme në nivele të ndryshme shoqërore, pasi seksualiteti luan një rol qendror në jetën e njeriut. Të rinjtë, kushtet e jetesës së të cilëve i bëjnë ata veçanërisht të lëndueshëm, siç janë migrantët, pakicat seksuale, personat me aftësi të kufizuara dhe njerëzit me një nivel të ulët arsimor, meritojnë vëmendje të veçantë. Për zhvillimin një edukimi seksual të përshtatshëm me nevojat e secilit, thelbësore është të njohësh nevojat e grupit të synuar në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues. Përveç kësaj, duhet të krijohen strategji përfshirëse për edukimin seksual. Kërkohej një bashkëpunim i frytshëm mes shkencëtarëve, vendimmarrësve politikë, specialistëve pedagogjikë dhe përfaqësuesve të grupeve të synuara, në mënyrë që të zhvillohen dhe zbatohen strategji optimale për një shoqëri të karakterizuar nga diversiteti.

### **Rëndësia e partneriteteve direkte dhe indirekte**

Edukimi seksual shkollor është një strategji solide për të arritur shumicën e fëmijëve dhe adoleshentëve. Sidoqoftë, këtu ka nevojë për partnere dhe partnerë të ndryshëm. Ata mund të ndahen në partnerë direkt dhe indirekt, edhe pse dallimi mes tyre nuk është gjithmonë i qartë. Partnerë të drejtpërdrejtë në edukimin seksual janë prindërit dhe kujdestarët e tjerë, mësuesit, punonjësit socialë, përfaqësues të grupmoshave të caktuara dhe vetë të rinjtë, si dhe personeli mjekësor dhe këshillues, domethënë njerëz që

kanë kontakte të drejtpërdrejta me fëmijët dhe të rinjtë. Nga ana tjetër, partnerët indirekt luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në edukimin seksual, siç janë mbështetësit dhe aktivistët bie fjala në politikë, përfshirë këtu edhe organizatat joqeveritare, komunitat, universitetet, institucionet ligjore dhe shkencore.

Organizatat fetare dhe kulturore si dhe organizatat rinore janë po ashtu aleatë të mundshëm, edhe pse varet nga rrethanat dhe mjedisi përkatës, nëse këto janë partnerë direkt (me kontakt të drejtpërdrejtë me të rinjtë) apo indirekt. Rrjetëzimi, shkëmbimi dhe bashkëpunimi me organizata dhe institucione të tilla rekomandohet kur duhet të adresohen grupe të caktuara siç janë të rinjtë me prejardhje të huaj, pakica kulturore, etj., për të cilët kuadri shkollor mund të mos jetë mënyra e vetme efektive për edukim seksual.

Eshtë treguar qartë, se një qasje përfshirëse çon në rezultate më të mira dhe në një aftësim më efikas. Për të planifikuar edukimin seksual, është e domosdoshme të caktohen partnerët kryesorë si dhe të mundësohet përfshirja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e masave pedagogjike. Eshtë e rëndësishme që këta partnerë të trajnohen, para se të japin një kontribut efektiv në një edukim seksual cilësor.

## 6. Si mund të arrihet me sukses edukimi seksual? Kushtet e përgjithshme dhe kërkesat

Premisa kryesore për edukimin seksual është që ai të ketë vendin e vet në shkollë dhe kështu të përfshihet në plan mësimor në të gjitha detajet. Ky fakt mund të tingëllojë i thjeshtë, por shpesh nuk i kushtohet rëndësi. Zbatimi i edukimit seksual duhet të garantohej nga institucione të ndryshme siç është vetë shkolla, por edhe nga autoritetet mbikëqyrëse dhe organet e kontrollit. Duhet të sigurohet kohë, hapësirë dhe personel i trajnuar, në mënyrë që të mundësohet edukimi seksual. Por edhe nëse nuk janë ende këto premisa, edukimi seksual është i realizueshëm.

### 6.1 Shtatë karakteristika të edukimit seksual

Siç është përmendur tashmë, edukimi seksual gjithëpërfshirës trajton një gamë të gjerë temash, ku bëjnë pjesë aspekte fizike, emocionale, sociale dhe kulturore. Ai nuk duhet të kufizohet vetëm në parandalimin e sëmundjeve, por ta fusë këtë aspekt në një perspektivë më të gjerë, joggjyuese dhe të mos përhapë frikëra. Në këtë mënyrë, ai mund të përcjellë një qëndrim pozitiv ndaj mirëqenies seksuale. Ky kuptim gjithëpërfshirës i edukimit seksual kërkon një përzgjedhje të kujdesshme të metodave të ndryshme që janë të përshtatshme për stile të ndryshme të të nxënësve dhe shqisa të ndryshme.

Një premisë e rëndësishme për edukimin seksual është që nxënëset dhe nxënësit të ndjehen gjithnjë të sigurtë. Privatësia dhe kufijtë e tyre duhet të respektohen. Edhe pse ata duhet të inkurajohen të jenë të hapur, përvojat personale nuk duhet të diskutohen, pasi ato nuk e kanë vendin në klasë dhe mund t'i bëjnë të rinjtë të lëndueshëm. Duhet krijuar një atmosferë besimi, në të cilën grupi formon rregulla konsensuale. Një edukim seksual i orientuar drejt gjinive ndihmon gjithashtu që nxënëset dhe nxënësit të kenë një ndjenjë sigurie.

Duke u bazuar në këto kërkesa të përgjithshme, sa i takon edukimit seksual mundësisht duhet të merren parasysh pikat e mëposhtme:

- **Përfshirja sistematike e të rinjve** përmirëson cilësinë e edukimit seksual. Nxënëset dhe nxënësit nuk janë adresatë pasivë të edukimit seksual, por luajnë një rol aktiv në organizimin, zbatimin dhe vlerësimin e tij. Kjo siguron që edukimi seksual të udhëhiqet nga nevojat përkatëse dhe jo të ndjekë thjesht një plan mësimor të paracaktuar. Peer education [edukimi përmes bashkëmoshatarëve], si një formë e veçantë e përfshirjes së të rinjve, ka dëshmuar të jetë e suksesshme në kontekste të ndryshme, veçanërisht për grupet që janë të vështira për t'u arritur. Sidoqoftë, këtu duhet të theksohet se bashkëmoshatarët duhet të trajtohen mirë, nëse është fjala të përfshihen në edukimin seksual.
- Edukimi seksual duhet të përcillet në formë **interaktive**. Shkëmbimi midis mësuesve ose drejtuesve të kurseve dhe atyre që e ofrojnë edukimin seksual nga njëra anë dhe nxënësve nga ana tjetër bëhet në disa nivele dhe fillon duke pranuar, se nxënësit duhet të respektohen si aleatë gjatë edukimit seksual. Përvojat e tyre duhet të merren parasysh dhe nevojat e dëshirata e tyre janë vendimtare në përcaktimin e temave dhe përmbajtjeve që do të trajtohen. Për edukimin seksual duhet të përdoret një gjuhë e përshtatshme për fëmijët ose adoleshentët dhe nxënësve duhet t'u jepet mundësia të mësojnë shprehjet e sakta, në mënyrë që ata të perfeksionojnë aftësitë e tyre komunikuese sa i përket seksualitetit. Komunikimi luan një rol qendror në edukimin seksual. Në praktikë, kjo do të thotë që mësuesi të heqë dorë nga roli i tij/saj qendror dhe më shumë të moderojë, në mënyrë që të mundësojë komunikim kuptimplotë midis nxënësve dhe të nxisë diskutimin. Në këtë mënyrë ata aftësohen të përcaktojnë vetë këndvështrimin e tyre dhe të reflektojnë mbi qëndrimin e tyre.

Dhe së fundmi, puna interaktive nënkupton gjithashtu përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies, duke marrë parasysh preferencat e ndryshme të të nxënësve dhe të përftohet me të gjitha shqisat. Muzika dhe teatri ose lojërat aplikative aktivizojnë strategji dhe potenciale të ndryshme mësimore dhe u drejtohen nxënësve në mënyrë më të drejtpërdrejtë.<sup>44</sup>

- Edukimi seksual është një proces **i vazhdueshëm** dhe bazohet në besimin, se zhvillimi seksual zgjat gjatë gjithë jetës. Edukimi seksual nuk është një proces që ndodh vetëm njëherë, por është pjesë e një projekti ose procesi, dhe përfshin ndryshimet e situatave të jetës së nxënësve. Termi «i përshtatshëm për moshën» lidhet ngushtë me këtë gjë: Temat trajtohen sërish dhe informacionet përpunohet në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve. Duhet të vihen në dispozicion shërbime shëndetësore dhe këshilluese që plotësojnë nevojat e të rinjve, ku mund të shkohet lehtësisht dhe janë të besueshme. Të rinjtë duhet të dinë që ka këto pika kontakti dhe të mund të krijojnë një marrëdhënie me punonjësit që karakterizohet nga respekti dhe besimi i ndërsjellë, në mënyrë që ata të mund të përdorin shërbimet e tyre, nëse lind nevoja.
- Vazhdimësia kohore e edukimit seksual plotësohet nga **kuadri i tij multisektoral**. Duke hyrë në bashkëpunim me partnerë brenda dhe jashtë shkollës, siç janë shërbimet shëndetësore dhe qendrat këshilluese, edukimi seksual shkollor ndërlidhet edhe me fusha të tjera. Në një kontekst më të ngushtë që është i kufizuar vetëm në kuadrin shkollor, edukimi seksual mund të përcillet edhe në formë interdisiplinore. Në lëndë të ndryshme mund të trajtohen aspekte të ndryshme, por po aq të rëndësishme.
- Edukimi seksual nuk kryhet në një vakum, por është i lidhur ngushtë me mjedisin mësimor dhe përvojat specifike të grupeve të synuara. Për këtë arsye, edukimi seksual **orientohet nga konteksti** dhe merr parasysh nevojat e nxënësve në një mënyrë të përshtatshme. Nxënësët dhe nxënësit ndryshojnë shumë përsa i përket

prejardhjes së tyre sociale dhe kulturore, çka duhet t'u kushtohet mjaftueshëm vëmendje (nuk ka një qasje të vetme). Moshë, gjinia, prejardhja shoqërore, orientimi seksual, stadi i zhvillimit dhe aftësitë individuale të secilit nxënës/e janë po ashtu faktorë të rëndësishëm. Një kuadër më të gjerë ofrojnë kurrikula të veçanta, të cilat përcaktojnë volumin dhe përmbajtjen e edukimit seksual, si dhe të drejtat universale të njeriut, me të cilat duhet të kombinohet edukimi seksual.

- Edukimi seksual krijon një bashkëpunim të ngushtë me **prindërit dhe komunitetin** për të krijuar një mjedis përkrahës. Prindërit përfshihen në edukimin seksual shkollor, që do të thotë se ata informohen para fillimit të edukimit seksual dhe kanë rastin të shprehin dëshirat dhe rezervat e tyre. Shkolla dhe prindërit përkrahin njëri-tjetrin gjatë edukimit të vazhdueshëm seksual. I dobishëm në fushën e edukimit seksual është po ashtu bashkëpunimi me grupet e tjera të interesit (punë rinore publike dhe fetare, kujdesi për të rinjtë, shërbime shëndetësore, qendra këshillimi, grupe fetare).
- Edukimi seksual është **i orientuar drejt gjinisë** në mënyrë që të sigurohet që kërkesat dhe shqetësimet e ndryshme specifike gjinore të merren parasysh mjaftueshëm. Për shembull, me anë të përzgjedhjes së metodave të përshtatshme, merren parasysh dallimet specifike gjinore gjatë të nxënësve ose mënyra si shtrohen çështjet e seksualitetit. Një mundësi për këtë është një ndarje e përkohshme në grupe sipas gjinisë dhe formimi i ekipeve të mësuesve, secili i përbërë nga një mësues mashkull dhe një femër.

## 6.2 Kualifikimi i stafit pedagogjik

Thelbi i edukimit seksual është kualifikimi i stafit pedagogjik. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se specialistët e edukimit seksual nuk duhet të jenë patjetër ekspertë të kualifikuar plotësisht. Mësuesit që do të merren me edukimin seksual, në rastin ideal duhet të trajnohen në këtë fushë. Megjithatë, mungesa e stafit të trajnuar siç duhet, nuk duhet të përdoret si pretekst për të

44 Ka përmbledhje të hollësishme të metodave të mësimdhënies të edukimit seksual; shembuj janë Hedgepeth & Helmich (1996) dhe Population Council (2009).

hequr dorë nga edukimi seksual. Edukimi seksual duhet të futet edhe atëherë, kur trajnimi i duhur i mësuesve nuk ka përfunduar ende.

Gjatë organizimit të kurseve, në programet përkatëse duhet të marret parasysh, se në ç'nivel është mësuesi/-ja (ose pedagogu/-ja) që do të japë mësim të edukimit seksual. Kërkesat në këtë drejtim ndryshojnë në varësi të llojit të shkollës dhe grupmohës; për shembull, një edukator/e kopshti ka nevojë për një trajnim të ndryshëm nga një mësues/e gjimazi.

Stafi pedagogjik kompetent jo vetëm që duhet të trajnohet për edukim seksual, por duhet që përveçse të jenë disi të hapur ndaj kësaj teme, të kenë edhe një motivim të lartë për mësimdhënien e tij. Me fjalë të tjera, ato duhet të jenë dakort me parimet e edukimit seksual të parashtruara në fillim. Kjo do të thotë që autoritetet shkollore nuk duhet të detyrojnë askënd të japë edukim seksual. Më mirë do të ishte, që ata t'i inkurajojnë dhe përkrahin mësuesit për këtë gjë.

Një premisë e rëndësishme është gatishmëria e mësuesve për të reflektuar mbi qëndrimet e tyre ndaj seksualitetit dhe vlerave e normave të shoqërisë, pasi ata shërbejnë si shembull për nxënësit. Pedagogët/-et seksualë kanë nevojë gjithashtu për struktura përkrahëse dhe mundësi për supervision (vëzhgim).

### **Nxitja e zhvillimit të aftësive përmes edukimit seksual**

Gjatë dhënies së edukimit seksual, pedagogët/-et me të vërtetë që duhet të paraqesin fakte, por ata duhet edhe të ndihmojnë nxënësit/-et që të zhvillojnë qëndrime dhe aftësi përkatëse. Aftësitë në komunikim, negociim, vetë-reflektim, vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve janë fokusi i një edukimi seksual me cilësi të lartë. Pedagogët/-et duhet të përdorin vazhdimisht një gjuhë neutrale gjatë trajtimit të temës së seksualitetit, në mënyrë që të mos t'i qortojnë

nxënësit dhe t'i respektojnë kufijtë e tyre. Mësimi i tyre duhet të bazohet në të drejtat e njeriut dhe në një përkushtim ndaj diversitetit në mënyrë që ata ta kuptojnë seksualitetin edhe si edukim në çështjet e të drejtave të njeriut dhe diversitetit<sup>45</sup>.

Roli, të kuptuarit dhe trajnimi i pedagogëve/-eve, si dhe kuadri strukturor, në të cilin ata punojnë, po bëhen gjithnjë e më i rëndësishëm për një edukimin seksual me cilësi të lartë.

<sup>45</sup> Nga pikëpamja kulturore, diversiteti do të thotë të vlerësosh se çdokush është i ndryshëm dhe unik. Talentet, përvojat dhe aftësitë e ndryshme, perspektivat dhe stilet e ndryshme, bie fjala në organizata multikulturore konsiderohen si pasurim (redaksia).



# Pjesa 2: Matrica e edukimit seksual

## 1. Hyrje

### 1.1 Informacione rreth kontekstit

Edukimi seksual është një temë e gjerë, dhe përmbajtja ndryshon kur fëmijët bëhen adoleshentë dhe më vonë të rinj madhorë. Në moshën 3 vjeç fëmija ka nevojë për informacione dhe një mbështetje tjetër sesa dhjetë vjet më vonë. Për më tepër, edukimi seksual ndikon në formimin e qëndrimeve ndaj seksualiteti dhe sjelljes seksuale dhe ndihmon individin gjatë zhvillimit të një seksualiteti vetëvendosës.

Matrica në vijim është përpiluar për të përcjellë një përmbledhje rreth temave që do të duhet të trajtoheshin në grupmoshat e veçanta. **Ajo është strukturuar sipas grupmoshave të ndryshme dhe përfshin tetë kategori kryesore temash.** Matrica mund të përdoret në mënyrë fleksible, që të marrë parasysh nevojat e veçanta të një individi ose të një grupi. Për më tepër, ajo mund të përshtatet për njerëz me nevoja të veçanta dhe për grupe pakicash. Ajo është një koncept kornizë, nga ku

drejtuesi i kursit ose pedagogu mund të nxjerrë tema të caktuara, që janë me interes për grupin e tij/saj.

Edukim seksual nuk do të thotë vetëm informacione, por ai përkrah edhe përvetësimin e aftësive dhe kompetencave si dhe ndihmon në zhvillimin e një pikëpamjeje dhe të një qëndrimi individual ndaj seksualitetit. Në këtë mënyrë ai i aftëson fëmijët dhe të rinjtë të marrin vendime me vullnetin e tyre të lirë dhe të drejtpeshuara. Prandaj secila kategori kryesore tematike është diferencuar edhe më tej sipas parametrave dituri/informacion, kompetenca, dhe qëndrime.

#### Dituri/informacion

Tek kjo përmbledhje, informacion quhet vënia në dispozicion në mënyrë të drejtpeshuar, të gjerë dhe të përshtatshme me moshën e fakteve nga sfera e edukimit seksual, si zhvillimi i trupit të njeriut, riprodhimi, aspektet pozitive dhe negative të seksualitetit, parandalimi i shtatzënive të padëshiruara dhe të infeksioneve seksualisht të transmetueshme si dhe abuzimi seksual. Këtu nuk bëhet fjalë kurrë për informacione që ndjellin

frikë ose që të jenë gjykuese, por për dituri për të fuqizuar dhe aftësuar (empowerment) fëmijët, po ashtu edhe rreth të drejtave të tyre seksuale.<sup>46</sup>

### **Kompetencat**

Në këtë përmbledhje kompetencat përkufizohen si aftësia për t'u sjellë në mënyrë objektive. Prandaj kompetencat kanë të bëjnë me aftësi praktike në lidhje me pyetjen, se çfarë duhet të zotërojnë nxënësit përveç përmbajtjeve mësimore. Tek edukimi seksual bëjnë pjesë kompetenca shumë të ndryshme si p.sh. të dish si të komunikosh, negociosh, të shprehësh ndjenjat ose si të përballësh me situata të padëshiruara. Po ashtu, e rëndësishme është të kesh aftësitë e nevojshme për t'u mbrojtur në mënyrë efektive nga shtatzënia dhe për të parandaluar sëmundjet ngjitëse, seksualisht të transmetueshme dhe të kërkohet ndihmë kur lindin probleme.

### **Qëndrimet**

Në këtë përmbledhje, qëndrimet përkufizohen si mendime dhe vlera të rrënjësura sa i përket tematikave të veçanta.

Qëndrimi ynë formon parimet themelore që përcaktojnë sjelljen tonë. Detyra e prindërve dhe e pedagogëve/pedagogeve është t'u japin fëmijëve dhe të rinjëve themele të forta përmes vetë sjelljes së tyre. Një fëmijë i vogël duhet të ketë ndjesinë, se është i mbrojtur dhe po aq me vlerë sa njerëzit e tjerë. Me fëmijët më të mëdhenj, prindërit dhe specialistët duhet të angazhohen që të respektojnë diversitetin dhe më vonë, pasi fëmijët të bëhen adoleshentë dhe të rinj, ata t'a përvetësojnë këtë qëndrim për veten dhe të tjerët. Një qëllim tjetër i rëndësishëm është zhvillimi i një qëndrimi pozitiv ndaj seksualitetit.

## **1.2 Rëndësia e strukturave mbështetëse**

Përveç njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, të rinjtë kanë nevojë për mbështetje në mënyrë që

të zotërojnë sfidat përkatëse specifike të zhvillimit. Ishte e pamundur të përfshiheshin të gjitha format e ndihmës në tabelën përmbledhëse; prandaj, paragrafët e mëposhtëm do të tregojnë se ç'loj ndihme mund të jetë e nevojshme. Procesi i pjekurisë në të cilin kalojnë fëmijët dhe të rinjtë nuk ndodh i izoluar, por brenda sistemeve sociale dhe shoqërore që ndikojnë dhe formësojnë zhvillimin dhe përvojën e tyre. Ekzistenca e sistemeve të tilla mbështetëse nuk mund të vihet si parakusht, megjithatë disa prej tyre duhet të përshtaten posaçërisht për të rinjtë dhe t'u paraqiten atyre. Në vijim do të përmenden disa struktura të mundshme mbështetëse.

### **Sfera ndërnjerëzore**

Prindërit, të afërmit e familjes, miqtë si dhe specialistët mund të ofrojnë mbështetje dhe të jenë të gatshëm si partnerë bisede. Në këtë mënyrë, të rinjtë mësojnë, se mund të komunikojnë ndjenjat dhe përvojat e tyre, se të tjerët i marrin seriozisht dhe se janë edhe vetë në gjendje të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë për të tjerët.

### **Burime të jashtme**

Informacione të përshtatura (faqe interneti, fletëpalosje, libra, etj.) dhe mediat (gazeta, interneti, televizioni, etj.) mund të luajnë një rol të rëndësishëm. Ato mund të përçojnë modele sjelljesh ose shembuj të dobishëm dhe të kujdesen që të rinjtë të kenë besim, se informacionet janë të sakta për nga përmbajtja dhe të përshtatura ndaj nevojave të tyre.

### **Mjedisi arsimor**

Kjo përfshin përcjelljen e fakteve themelore për fëmijët dhe të rinjtë, mundësimin e mësimin dhe komunikimit, si dhe mbledhjen e materialit didaktik që përputhet me nevojat dhe pyetjet e tyre të veçanta. Njëkohësisht duhet të krijohen hapësira dhe mundësi mësimi, në mënyrë që fëmijët të bëjnë përvojat e tyre në një mjedis të sigurtë dhe stimulues.

### **Shërbimet**

Për fëmijët dhe të rinjtë duhet të ketë në dispozicion specialistë, që t'u përgjigjen pyetjeve të tyre dhe t'u ofrojnë ndihmën që u nevojitet. Gjithashtu duhet të ketë strategji lokale për të mbrojtur të drejtat dhe sigurinë e fëmijëve dhe të

<sup>46</sup> «Të drejta seksuale» sipas kapitullit 2, do të thotë se jo të gjitha të drejtat aplikohen automatikisht tek fëmijët dhe të rinjtë.



rinjve: Pika të tilla kontakti duhet të financohen mjaftueshëm, të bëhen të arritshme për të rinjtë dhe të jenë pjesë e jetës së përditshme.

### 1.3 Pse është mirë që edukimi seksual të fillohet që para moshës katër vjeç

Siç është përmendur tashmë, në këtë koncept komizë përdoret një term i zgjeruar, githëpërfshirës i edukimit seksual, i cili bazohet në një kuptim të seksualitetit si një potencial pozitiv njerëzor. Prandaj, një fëmijë shihet si një qenie seksuale që kur lind, paçka se seksualiteti i tij ndryshon në shumë pikëpamje nga ai i një të rrituri, përkatësisht në të shprehurit, në përmbajtje dhe qëllime. Në çdo grupmoshë dhe fazë zhvillimi, lindin pyetje dhe mënyra sjelljeje të caktuara, ndaj të cilave duhet të reagohet në mënyrë edukative. Si zhvillim psikoseksual gjatë fëmijërisë cilësohet zhvillimi i aftësive të ndryshme fizike, emocionale, kognitive dhe sociale që janë karakteristike për moshën e fëmijës. Një paraqitje më e detajuar e zhvillimit psikoseksual të fëmijëve mund të gjendet në kapitullin 3.2.

Sipas këtij këndvështrimi, edukimi seksual është shumë më tepër sesa thjesht dhënia e fakteve për riprodhimin dhe parandalimin e sëmundjeve. Përkundrazi, ai promovon zhvillimin sensual të fëmijës, perceptimin e trupit dhe imazhin e tij për trupin e vet, forcon vetëbesimin e tij dhe zhvillon aftësinë e tij për të vetëvendosur – fëmija aftësohet të veprojë në mënyrë të pavarur dhe në mënyrë të përgjegjshme për veten dhe partnerin.

Edukimi i fëmijës fillon me lindjen e tij, fillimisht përmes mesazheve joverbale, më vonë gjithnjë e më shumë përmes atyre verbale. Edukimi seksual është pjesë e edukimit të përgjithshëm të fëmijës dhe i përcillet fëmijës edhe nëse kjo nuk bëhet me vetëdije. Mënyra se si prindërit sillen me njëritjetrin është një shembull i gjallë për fëmijën për të parë, se si funksionojnë marrëdhëniet. Për më tepër, prindërit shërbejnë si shembull për rolet gjinore dhe mënyrën se si shprehen emocionet, seksualiteti dhe butësia. Duke mos folur për seksualitetin (p.sh., duke mos përmendur

organet seksuale), prindërit tashmë po përcjellin një mesazh për seksualitetin (në këtë shembull, heshtja e tyre mund të interpretohet si siklet). Edhe mjedisi i përgjithshëm i fëmijës ndikon po ashtu në socializimin e tij seksual, siç është kureshtja e fëmijëve të tjerë në kopsht për trupin e vet ose të të tjerëve.

Mësimdhënia dhe të nxënit e pavetëdijshëm ose të vetëkuptueshëm sa i takon seksualitetit mund të plotësohet me mësimdhënie aktive dhe përcjellje informacionesh, ku tema trajtohet si diçka normale, e përditshme. Pyetjeve të fëmijës u përgjigjet në një mënyrë të përshtatshme për moshën dhe atij i jepet të kupohet se temat seksuale janë pozitive dhe të këndshme. Në këtë mënyrë, fëmija mund të zhvillojë një mendim pozitiv ndaj trupit të tij dhe të përvetësojë aftësitë e duhura të komunikimit (siç është emërtimi i saktë i pjesëve të trupit). Në të njëjtën kohë, fëmijës i jepet të kuptojë, se ka kufij individualë dhe rregulla shoqërore që duhet të respektohen («Nuk mund të shkosh e të prekësh gjithkënd»). Sidoqoftë, edhe më e rëndësishme është që fëmija mëson të njohë kufijtë e vet dhe t'i shprehë ato me fjalë («E ke të drejtën të thuash jo; mund të kërkosh ndihmë»). Në këtë kuptim, edukimi seksual është gjithashtu edukim social dhe përkrah parandalimin e abuzimit seksual.

### 1.4 Shpjegime rreth matricës

Gjatë strukturimit të përmbajtjes së asaj çka duhet të mësohet në një moshë të caktuar, janë përcaktuar **grupmosha** të ndryshme në varësi të detyrave zhvillimore:<sup>47</sup> 0–4, 4–6, 6–9, 9–12, 12–15 dhe 15 vjeç e lart. Ato përkohet me grupmoshat e OBSH-së dhe pasqyrojnë fazat e zhvillimit. Sigurisht që ka raste kur, për shkak të zhvillimit të tyre personal, fëmijët përshtaten më mirë në një grupmoshë të ndryshme nga ajo që përkon me moshën e tyre reale. Prandaj, kufijtë midis grupmoshave duhet të shikohen në mënyrë fleksibile. Temat e trajtuara në

<sup>47</sup> Një detyrë zhvillimore është një sfidë që lind në një fazë të caktuar të jetës së individit dhe e cila, kur përballohet me sukses, e bën individin të lumtur dhe çon në përballimin me sukses të sfidave të mëvonshme, kurse nëse dështon, e mërzit atë, ngjall mosmiratimin e shoqërisë dhe shkakton vështirësi në sfidat pasuese. Krh. Havighurst (1971), f. 2.

faza të ndryshme duhet të kuptohen si pararendëse të fazave të zhvillimit që vjen menjëherë më pas ose atyre të mëvonshme, në mënyrë që fëmijët të jenë të përgatitur më mirë për këto tema. Sigurisht, që këtu merren parasysh edhe nivelet e ndryshme të të kuptuarit.

Për të gjitha grupmoshat, temat janë përmbledhur tek **fushat e përgjithshme tematike**: «Trupi i njeriut dhe zhvillimi njerëzor», «Fertiliteti dhe shumimi», «Seksualiteti»<sup>48</sup>, «Emocionet», «Marrëdhëniet dhe stilet e jetesës», «Seksualiteti, shëndeti dhe mirëqenia», «Seksualiteti dhe të drejtat» dhe «Përcaktorët socialë dhe kulturorë të seksualitetit». Këto tema u zgjodhën sepse janë të rëndësishme për procesin dinamik të zhvillimit seksual fizik, social dhe emocional tek adoleshentët.

Është e rëndësishme që të gjitha temat të trajtohen në një mënyrë të përshtatshme për moshën dhe për fazën e zhvillimit. Në grupmoshën 0–4 vjeç, për shembull, fëmijët duhet të përftojë qëndrimin «respekt kundrejt barazisë gjinore». Në shikim të parë, kjo duket shumë temë e largët për këtë grupmoshë, por ajo që nënkuptohet këtu, është përvetësimi i qëndrimit, se djemtë dhe vajzat janë të njëjvlershëm. Ky qëndrim themelor që nga fillimi mund të shërbejë si një bazë solide për zhvillimin e mëvonshëm të vlerave dhe normave. Në fazën e hershme futen bazat e temave të caktuara, në fazat e mëvonshme këto tema trajtohen përsëri dhe thellohen.

Kur të punoni me këtë përmbledhje do të vini re **shenjime dhe etiketime të ndryshme**: Temat e theksuara me ngjyrë portokalli janë temat kryesore ose standardet minimale që duhet të trajtohen në kuadrin e edukimit seksual. Temat e pashenjuara janë plotësime; përfshirja e tyre në plane mësimore është fakultative. Shkrimi me ngjyrë të çelët tregon se tema përkatëse, kjo kompetencë ose ky qëndrim është prezantuar tashmë në një grupmoshë më të re. Kjo ndodh shumë shpesh, pasi shumë tema shpesh rikthehen në grupmoshat e mëvonshme në mënyrë më të hollësishme dhe me një fokus të ndryshëm.

- Tema kryesore (e re)
- Tema kryesore (thellim)
- Tema shtesë (e re)
- Tema shtesë (thellim)

Disa tema nuk kufizohen vetëm në kategori të caktuara dhe shfaqen nëpër kategori kryesore tematike të ndryshme. Shembulli më i mirë i kësaj është abuzimi seksual, disa aspekte të të cilit mund të gjenden tek «Seksualiteti, shëndeti dhe mirëqenia» dhe të tjera tek «Seksualiteti dhe të drejtat».

48 Në përmbledhje, termi «seksualitet» përdoret në një kuptim të ngushtë për arsye praktike dhe i referohet vetëm trupit, intimitetit dhe përvojës seksuale.

# Matrica

Grupmosha 0–4	42
Grupmosha 4–6	44
Grupmosha 6–9	46
Grupmosha 9–12	48
Grupmosha 12–15	50
Grupmosha 15 dhe më të rritur	52

## Trupi i njeriut dhe zhvillimi njerëzor

- të gjitha pjesët e trupit dhe funksionet e tyre
- trupa të ndryshëm dhe gjini të ndryshme
- higjiena e trupit
- ndryshmet midis vetes dhe të tjerëve

- cilësimi i pjesëve të trupit
- praktikimi i higjienës (larja e çdo pjese të trupit)
- njohja e ndryshimeve trupore
- shprehja e dëshirave dhe nevojave

- imazhi pozitiv i trupit dhe i vetes: vetëvlerësimi
- respektimi i ndryshimeve
- njohja e vlerave të trupit tuaj
- njohja e vlerave të ndjenjes së mirëqënies, të afritetit dhe të besimit, e cila formohet nga përvoja e e trupit dhe përjetimet e bëra nga një lidhje e besueshme
- respektimi i barazisë gjinore

## Fertiliteti dhe shumimi

- shtatëzania, lindja dhe foshnjt
- bazat e shumimit njerëzor (nga vijnë foshnjt?)
- mundësi të ndryshme, për të qenë anëtar i një familje (p.sh. adoptimi)
- fakti, që disa njerëz kanë fëmijë dhe disa të tjerë jo

- të flasim rreth kësaj, të njohim fjalorin e duhur

- pranimi, që ekzistojnë mundësi të ndryshme për t'u bërë fëmija i një familjeje

## Seksualiteti

- argëtimi dhe dëshira për prekjen e trupit, masturbimi në moshën e fëmijërisë
- zbulimi i trupit tuaj dhe i organeve tuaja gjinitale
- përvojë e këndshme, afërsia fizike si pjesë e jetës njerëzore
- sjellja e ëmbël dhe afërsia fizike, si një shprehje e dashurisë dhe e përkushtimit

- zhvillimi i vetëdijes për identitetin
- të flasim për ndjenjat e (pa) këndshme të trupit tuaj
- të shprehim nevojat tona, dëshirat dhe kufijtë, për shembull gjatë «lojërave të dashurisë»

- mendim pozitiv në lidhje me trupin tuaj dhe funksionet e tij (imazh pozitiv për trupin)
- respektimi i të tjerëve
- kureshtje për trupin tonë dhe trupin e të tjerëve

## Emocionet

- lloje të ndryshme të dashurisë
- ndjenjat e pranimit dhe të mohimit
- terma/fjalë për ndjenjat
- nevoja për privatësi

- të ngjallim dhe të shfaqim dhembshuri
- të themi Po ose Jo
- të shprehim dhe të komunikojmë emocionet, dëshirat dhe nevojat tona
- të shprehim nevojën tonë për privatësi

- mirëkuptim për faktin, që emocionet mund të shprehen në shumë forma të ndryshme
- mendim pozitiv për gjininë tonë biologjike dhe sociale (është mirë, që të jesh një djalë apo një vajzë)
- mendimi, që përvojat tona dhe përshtypja personale në lidhje me ndjenjat, janë të sakta
- mendim pozitiv për emocionet e ndryshme, në situata të ndryshme

0-4	Njohuritë Vënia në dispozicion e informacioneve	Kompetencat Aftësi i fëmijëve	Mendimet Përkrahja e zhvillimit të mendimeve pozitive
Marrëdhëniet dhe stilet e jetesës	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ lloje të ndryshme të marrëdhënieve</li> <li>■ marrëdhënie familjare të ndryshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të flasim në lidhje me marrëdhëniet tona dhe familjen tonë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ ndjenja e afërsisë dhe e besimit, e cila bazohet mbi përvojën e lidhjeve</li> <li>■ mendim pozitiv në lidhje me stilet e ndryshme të jetesës</li> <li>■ të jemi të vetëdijshëm në lidhje me shumëllojshmërinë e marrëdhënieve</li> </ul>
Seksualiteti, shëndeti dhe mirëqenia	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ përvojë e mirë dhe e keqe me trupin tuaj (Çfarë të bën të ndihesh mirë? Dëgjoni, se për çfarë ka nevojë trupi juaj)</li> <li>■ kini besim tek përvoja ose tek ndjenjat tuaja (mos u dorëzoni, kur nuk keni ndjenjat e duhura)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ kini besim tek instiktet tuaja</li> <li>■ përdorni modelin tre-fazor (thoni Jo, largohuni dhe flisni me dikë, tek i cili mund të keni besim)</li> <li>■ ndihuni mirë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ vlerësoni trupin tuaj</li> <li>■ të jeni të vetëdijshëm se është mirë të kërkohsh ndihmë</li> </ul>
Seksualiteti dhe të drejtat	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ e drejta për të qenë i sigurt dhe i mbrojtur</li> <li>■ përgjegjësia e të rriturve për sigurinë e fëmijëve</li> <li>■ e drejta për të drejtuar pyetje në lidhje me seksualitetin</li> <li>■ e drejta për të eksploruar identitetin seksual</li> <li>• e drejta për të eksploruar lakuriqësinë dhe trupin dhe për të qenë kurjoz</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të themi Po ose Jo</li> <li>■ të zhvillojmë kompetenca komunikative</li> <li>■ të shprehim dëshirat dhe nevojat</li> <li>• të bëjmë dallim midis të fshehtave të mira dhe të këqija</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ vetëdija për të drejtat tona, mbi të cilat krijohet vetëbesimi</li> <li>■ mendimi: «Trupi im më përket mua»</li> <li>■ vetëdija, që kemi të drejtë të marrim vendimet tona</li> </ul>
Përcaktorët socialë dhe kulturorë të seksualitetit (vlerat dhe normat)	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ rolet sociale dhe normat ose vlerat kulturore</li> <li>■ rolet e gjinive</li> <li>■ ruajtja e distancave të ndryshme sociale</li> <li>• ndikimi i moshës mbi seksualitetin dhe sjelljen e përshatshme për moshën</li> <li>• normat për lakuriqësinë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të dallojmë ndryshimet e sjelljes në ambjentet private dhe në ato publike</li> <li>■ respektimi i roleve sociale dhe normave kulturore</li> <li>■ si të sillemi në mënyrën e duhur në kontekstin përkatës</li> <li>• të dijmë, se ku janë të pranueshme prekjet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ respektimi i trupit tuaj dhe i trupit të tjerëve</li> <li>■ pranimi i rregullave sociale për privatësinë dhe intimitetin</li> <li>■ respektimi i përgjigjes së të tjerëve Po dhe Jo</li> </ul>

■ Tema kryesore (e

■ Tema kryesore (thellim)

• Tema shtesë (e

• Tema shtesë (thellim)

## Trupi i njeriut dhe zhvillimi njerëzor

- të gjitha pjesët e trupit dhe funksionet e tyre
- trupa të ndryshëm dhe gjini të ndryshme
- higjiena e trupit
- *dallimet e moshës sipas zhvillimit specifik dhe fizikës trupore*

- cilësimi i pjesëve të trupit
- praktikimi i higjenës (larja e çdo pjese të trupit)
- njohja e ndryshimeve trupore
- shprehja e dëshirave dhe nevojave
- *nevojat tona për privatësi dhe pranimi i nevojave të të tjerëve*

- **identitet pozitiv i gjinive**
- imazhi pozitiv i trupit dhe i vetes: vetëvlerësimi
- respektimi i ndryshimeve
- respektimi i barazisë së gjinive

## Fertiliteti dhe shumimi

- **mitet e shumimit (për shembull në disa vende fëmijëve u tregohet, që foshnjën e re e solli lejteku)**
- jeta: shtatzënia, lindja dhe foshnjët; fundi i jetës
- bazat e shumimit të njeriut

- të flasim rreth kësaj, të njohim fjalorin e duhur

- *respektimi i dallimeve: disa njerëz kanë fëmijë, disa jo*

## Seksualiteti

- argëtimi dhe dëshira për prekjen e trupit, masturbimi në fëmijërinë e hershme
- zbulimi i trupit tuaj dhe i organeve tuaja gjinitale
- *kuptimi dhe format e shprehjes së seksualitetit (për shembull si të shprehim dashurinë)*
- *gjuha e duhur seksuale*
- *ndjenjat seksuale (afërsia, dëshira, eksitimi) si pjesë e ndjenjave të përgjithshme njerëzore (këto duhet të jenë ndjenja pozitive; detyrimi dhe vuajtja nuk përfshihen këtu)*

- **të flasim rreth temave seksuale (kompetenca komunikative)**
- **të forcojmë identitetin seksual**
- *të përdorim gjuhën seksuale, pa ofenduar njeri*

- imazhi pozitiv i trupit
- respektimi i të tjerëve

## Emocionet

- **xhelozia, zemërimi, agresioni, zhgënjimi**
- **shoqëria dhe dashuria për njerëzit e një gjinie**
- *dallimi midis miqësisë dhe dashurisë*
- *dashuria e fshehtë, dashuria e parë (të qenurit i dashuruar dhe «i marruar», dashuri e pashprehur)*

- **si të trajtojmë zhgënjimet**
- të shprehim dhe të komunikojmë emocionet, dëshirat dhe nevojat tona
- *si të trajtojmë nevojën tonë dhe atë të të tjerëve për privatësi*
- *të cilësojmë saktë ndjenjat tona*

- **pranimi, që ndjenjat e dashurisë i përkasin botës së përgjithshme të ndjenjave dhe se ato janë të natyrshme**
- **qendrimi, që përvoja dhe shprehja e ndjenjave janë të duhura dhe me rëndësi (Vlerësim i ndjenjave të veta)**

# 4–6

## Njohuritë

Vënia në dispozicion e informacioneve

## Kompetencat

Aftësi i fëmijëve

## Mendimet

Përkrahja e zhvillimit të mendimeve pozitive

Marrëdhëniet dhe stilet e jetesës

- lidhjet shoqërore
- marrëdhëniet e personave të një gjinie
- lloje të ndryshme të marrëdhënieve (familjare)
- *mendime të ndryshme për familjen*

- të nisim një marrëdhënie në formën e duhur, me njëri-tjetrin, me anëtarë të familjes dhe shokë
- bashkëjetesa në familje e bazuar mbi respektin reciprok
- ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve

- pranimi i shumëllojshmërisë
- respektimi i stileve të ndryshme të jetesës

Seksualiteti, shëndeti dhe mirëqenia

- përvojë e mirë dhe e keqe me trupin tuaj (Çfarë të bën të ndihesh mirë? Ndjeni, se për çfarë ka nevojë trupi juaj)
- kini besim tek përvoja ose tek ndjenjat tuaja (mos u dorëzoni, kur nuk keni ndjenjat e duhura)

- kini besim tek instiktet tuaja dhe përdorni modelin tre-fazor (thoni Jo, largohuni dhe flisni me dikë, tek i cili mund të keni besim)
- ndihuni mirë

- vetëdija për të mund të zgjedhur
- ndërgjegjësimi për rrezikun
- vlerësimi i vlerave të trupit tonë
- të jeni të vetëdijshëm se është mirë të kërkojsh ndihmë

Seksualiteti dhe të drejtat

- dhuna (ka disa njerëz, të cilët nuk janë të dashur; ata shtiren sikur janë të sjellshëm, por mund të jenë të dhunshëm)
- të drejtat e fëmijëve (përfshirë të drejtat për informim dhe të drejtat për mbrojtje)
- përgjegjësia e të rriturve për sigurinë e fëmijëve

- drejtoni pyetje
- drejtohuni në rast problemesh një personi të besueshëm
- shprehni dëshirat dhe nevojat

- mendimi: «Trupi im më përket mua!»
- vetëdije për të drejtat tuaja

Përcaktorët socialë dhe kulturorë të seksualitetit (vlerat dhe normat)

- ndryshimet specifike gjinore, kulturore dhe të moshës
- ndryshimet e vlerave dhe normave sipas vendeve dhe kulturave
- pranimi i të gjitha ndjenjave, por sigurisht jo gjithçka që bëhet bazuar në këto ndjenja
- rolet sociale dhe normat ose vlerat kulturore

- të njohim dallimet midis vlerave dhe t'u përgjigjemi atyre
- respektimi i roleve sociale dhe i normave kulturore
- *të flasim për dallimet*

- sjellje me përgjegjësi sociale
- mendim i hapur, i lirë nga paragjykimi i vlerave
- pranimi i të drejtave të barabarta
- respektimi i normave të ndryshme për seksualitetin
- respektimi i trupit tonë dhe i trupit të tjerëve

■ Tema kryesore (e

■ Tema kryesore (thellim)

• Tema shtesë (e

• Tema shtesë (thellim)

Trupi i njeriut dhe zhvillimi njerëzor

- ndryshimet në trup, menstruacionet, ejakulimet, dallimet individuale gjatë zhvillimit afatgjatë
- dallimet (biologjike) dallimet midis burrit dhe gruas (të brendshmet dhe të jashtmet)
- higjena e trupit

- të njohim dhe të përdorim termat e sakta për pjeset e trupit dhe funksionin e tyre
- të perceptojmë ndryshimet në trup
- të kontrollojmë dhe të kujdesemi për trupin tonë

- pranimi i pasigurive, të cilat shkaktohen nga ndërgjegjësimi për trupin
- imazh pozitiv për trupin dhe për veten: vetëvlerësim
- identitet pozitiv i gjinive

Fertiliteti dhe shumimi

- marrja e vendimeve në lidhje me të qenurit prind dhe shtatzëninë, infertilitetin, adoptimin
- termat bazë të kontracepsionit (është e mundur, që të planifikojmë familjen tonë dhe të vendosim në lidhje me këtë)
- metodat e ndryshme të kontracepsionit
- termat bazë të ciklit të fertilitetit
- mitet e shumimit

- të zhvillojmë kompetenca komunikative
- të forcojmë mirëkuptimin, që fertiliteti jonë është i ndikueshëm

- të pranojmë shumëllojshmërinë – disa njerëz vendosin që të kenë fëmijë, disa të tjerë jo

Seksualiteti

- dashuria dhe të qenurit i dashuruar
- sjellja e ëmbël
- seksi në media (edhe në internet)
- argëtimi dhe dëshira gjatë prekjes së trupit tonë (masturbimi, stimulimi i vetes)
- gjuha e duhur seksuale
- marrëdhënia seksuale

- të pranojmë nevojën tonë dhe atë të të tjerëve për privatësi
- si të trajtojmë seksin nëpër media
- të përdorim gjuhën seksuale, pa ofenduar njeri

- të kemi mirëkuptim për «seksin e pranueshëm» (me konsens, me vullnet të lirë, të barabartë, sipas moshës, të kryer në kontekstin e përshtatshëm dhe duke ruajtur vetëvlerësimin)
- të jemi të vetëdijshëm, që seksi në media prezantohet në lloje dhe mënyra të ndryshme

Emocionet

- dallimet midis miqësisë, dashurisë dhe dëshirës
- xhelozia, zemërim, agresion, zhgënjim
- dallimi midis miqësisë dhe dashurisë
- dashuria e fshehtë, dashuria e parë (të qenurit i dashuruar dhe «i marruar», dashuri e pashprehur)

- të shprehim dhe të komunikojmë emocionet, dëshirat dhe nevojat tona
- si të trajtojmë zhgënjimet
- të cilësojmë saktë ndjenjat tona
- si të trajtojmë nevojën tonë dhe atë të të tjerëve për privatësi

- pranimi, që ndjenjat e dashurisë i përkasin botës së përgjithshme të ndjenjave dhe se ato janë të natyrshme
- qëndrimi, që përvoja dhe shprehja e ndjenjave janë të duhura dhe me rëndësi (vlerësimi i ndjenjave tona)



## 6–9

## Njohuritë

Vënia në dispozicion e informacioneve

## Kompetencat

Aftësi i fëmijëve

## Mendimet

Përkrahja e zhvillimit të mendimeve pozitive

Marrëdhëniet dhe stilet e jetesës

- marrëdhënie të ndryshme përsa i përket dashurisë, miqësisë etj.
- marrëdhënie të ndryshme familjare
- *martesa, divorci, bashkëjetesa*

- të gjejmë veten brenda një marrëdhënie
- të negociojmë kompromise, të tregojmë tolerancë dhe dhembshuri
- të krijojmë kontakte sociale dhe të lidhim miqësi

- pranimit të angazhimit (Commitment), përgjegjësi dhe sinqeritet, si bazë për marrëdhëniet
- respekt për të tjerët
- pranimit të shumëllojshmërisë

Seksualiteti, shëndeti dhe mirëqenia

- ndikimi pozitiv i seksualitetit mbi shëndetin dhe mirëqenien
- sëmundjet në lidhje me seksualitetin
- dhunë seksuale dhe agresion
- *oferta ndihme*

- vendosni kufijtë
- kini besim tek instiktet tuaja dhe përdorni modelin tre-fazor (thoni Jo, largohuni dhe flisni me dikë, tek i cili mund të keni besim)

- ndjenja e përgjegjësisë për shëndetin tonë dhe për mirëqenien tonë
- vetëdije për mundësitë ekzistuese të zgjedhjes dhe mundësitë e tjera
- ndërgjegjësimi për rrezikun

Seksualiteti dhe të drejtat

- e drejta për të përmbushur vetëveten
- të drejtat seksuale të fëmijëve (informacionet, edukimi seksual i fëmijëve, integriteti i trupit)
- abuzimi seksual
- përgjegjësia e të rriturve për sigurinë e fëmijëve

- merrni ndihmë dhe informacionet e ofruara
- drejtohuni në rast problemesh një personi të besueshëm
- *cilësoni të drejtat tuaja*
- *shprehni dëshirat dhe nevojat tuaja*

- ndjenja e përgjegjësisë për veten dhe të tjerët
- vetëdija për të drejtat dhe mundësitë për të zgjedhur

Përcaktorët socialë dhe kulturorë të seksualitetit (vlerat dhe normat)

- rolet e gjinive
- dallimet specifike kulturore
- dallimet e moshës

- të flasim për përvojat tona, dëshirat dhe nevojat në lidhje me normat kulturore
- të pranojmë vlera të ndryshme dhe të dimë të sillemi me to

- respekt për stilet e ndryshme të jetesës, vlerat dhe normat

■ Tema kryesore (e

■ Tema kryesore (thellim)

• Tema shtesë (e

• Tema shtesë (thellim)

## Trupi i njeriut dhe zhvillimi njerëzor

- higjiena e trupit (menstruacionet, ejakulimi)
- ndryshimet në fazën fillestare të pubertetit (ndryshimet mendore, fizike, sociale dhe emocionale dhe shumëllojshmëria në këtë fushë)
- organet e brendshme dhe të jashtme gjenitale dhe riprodhuese si dhe funksionet e tyre

- të integrojmë ndryshimet në jetën tonë
- të njohim dhe të përdorim termat e sakta
- të bisedojmë me të tjerët rreth ndryshimeve gjatë pubertetit

- të kemi mirëkuptim dhe të pranojmë ndryshimet në trup dhe dallimet (madhësia dhe forma e penisit, e gjokseve dhe e vulvës mund të variojnë, ideali i bukurisë mund të ndryshojë me kalimin e kohës dhe ai mund të ndryshojë në grupet e ndryshme kulturore)
- imazh pozitiv për trupin dhe veten: vetëvlerësim

## Fertiliteti dhe shumimi

- shumimi dhe planifikimi i familjes
- lloje të ndryshme të parandalimit të shtatzënisë dhe përdorimi i tyre; mitet për kontracëpsionin
- simptomat e shtatzënisë, rreziku dhe pasojat e marrëdhënies seksuale të pambrojtur (shtatzëni e padëshiruar)

- të kuptojmë lidhjen midis menstruacionit, ejakulimit dhe shumimit
- të përdorim në të ardhmen në mënyrë efektive prezervativët dhe mjete të tjera kontracëpsive

- vetëdija, që të dy gjinitë janë përgjegjës për parandalimin e shtatzënisë

## Seksualiteti

- përvojat e para seksuale
- orientimi gjinor
- sjellja seksuale e adoleshentëve (aftësia për të ndryshuar sjelljen seksuale)
- dashuria dhe të qenurit i dashuruar
- dëshira, masturbimi, orgazma
- dallimet midis identitetit gjinor dhe gjinisë biologjike

- të komunikojmë dhe të kuptojmë ndjenjat seksuale dhe të flasim në mënyrë të përshtatshme për seksualitetin
- të vendosim me vetëdije, nëse dëshirojnë të kemi ose jo përvoja seksuale
- të refuzojmë përvojat seksuale të padëshiruara
- të dallojmë midis seksualitetit «në jetën reale» dhe seksualitetit nëpër media
- të përdorim mediat moderne (telefonat celulare, interneti) dhe të jemi të vetëdijshëm për rrezikun dhe përparësitë e tyre

- respekt dhe mirëkuptim për shumëllojshmërinë dhe orientimin seksual dhe pranimin e tij (seksi duhet të kryehet me konsens, me vullnet të lirë, të barabartë, sipas moshës, të kryhet në kontekstin e përshtatshëm; vetëvlerësimi duhet të ruhet)
- mirëkuptim i seksualitetit si proces i të mësuarit
- pranimi i formave të ndryshme shprehëse të seksualitetit (puthja, prekja, ledhatimi etj.)
- vetëdije, që çdokush ka planin e tij kohor për zhvillimin seksual

## Emocionet

- emocione të ndryshme si kureshtja, të jesh i dashuruar, pasiguria, turpi, frika dhe xhelozia
- dallimet midis nevojave individuale për intimitet dhe privatësi
- dallimet midis miqësisë, dashurisë dhe dëshirës
- miqësia dhe dashuria e njerëzve të së njëjtës gjini

- të shprehim emocione të ndryshme dhe t'i pranojmë ato tek vetja dhe tek të tjerët
- të shprehim nevojat, dëshirat dhe kufijtë dhe të pranojmë ato të të tjerëve
- të dimë të sillemi me zhgënjimet

- mirëkuptim për emocionet dhe vlerat (të mos ndihemi fajtor për shkak të ndjenjave ose dëshirave seksuale)
- respekt për privatësinë e të tjerëve

9–12	Njohuritë Vënia në dispozicion e informacioneve	Kompetencat Aftësi i fëmijëve	Mendimet Përkrahja e zhvillimit të mendimeve pozitive
Marrëdhëniet dhe stilet e jetesës	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Dallimet midis miqësisë, shoqërisë dhe marrëdhënieve si dhe midis formave të ndryshme të takimit (Dating)</li> <li>■ lloje të ndryshme të marrëdhënieve të këndshme dhe të pakëndshme; influenza e pabarazisë (gjinore) mbi marrëdhëniet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të shprehim miqësinë dhe dashurinë në mënyra të ndryshme</li> <li>■ të krijojmë kontakte sociale, të lidhim shoqëri dhe të ndërtojmë e të ruajmë marrëdhëniet</li> <li>• të komunikojmë pritshmëritë dhe nevojat tona në një marrëdhënie</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ mendim pozitiv për barazinë gjinore në një marrëdhënie dhe për zgjedhjen e lirë të partnerit</li> <li>■ pranim i angazhimit, përgjegjësisë dhe sinqeritetit, si bazë për marrëdhëniet</li> <li>■ respekt për të tjerët</li> <li>• kuptimi i ndikimit të gjinisë, moshës, fesë, kulturës etj. në marrëdhënie</li> </ul>
Seksualiteti, shëndeti dhe mirëqenia	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ simptomat, rreziku dhe pasojat e përvojave seksuale të pambrojtura, të pakëndshme dhe të padëshiruara (infeksionet e transmetuara nga marrëdhëniet seksuale, HIV, shtatzënitë e padëshiruara, pasojat psikologjike)</li> <li>■ shkalla e përhapjes dhe llojet e ndryshme të abuzimit seksual, parandalimi dhe përkrahja/ndihma</li> <li>■ ndikimi pozitiv i seksualitetit mbi shëndetin dhe mirëqenien</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të marrim përgjegjësi për veten dhe për të tjerët në lidhje me përvojën e sigurtë dhe të këndshme seksuale</li> <li>■ të cilësojmë kufijtë dhe dëshirat dhe të shmangim përvojën e pasigurtë dhe të padëshiruar seksuale</li> <li>• të kërkojmë ndihmë dhe përkrahje në rast problemesh (pubertet, marrëdhënie, etj.)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ vetëdije në lidhje me ekzistencën e opsioneve dhe të mundësive të tjera</li> <li>■ ndërgjegjësimi për rrezikun</li> <li>• ndjenja e përgjegjësisë reciproke për shëndetin dhe mirëqenien</li> </ul>
Seksualiteti dhe të drejtat	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të drejtat seksuale, sipas përkufizimit të IPPF dhe WAS*</li> <li>• ligjet dhe dispozitat kombëtare (kufijtë për mbrojtjen e moshës)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të veprojmë në kaudër të këtyre të drejtave dhe përgjegjësisë</li> <li>• të marrim ndihmë dhe informacion</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ vetëdije në lidhje me të drejtat dhe mundësitë për të zgjedhur</li> <li>• pranimi i të drejtave seksuale për veten dhe të tjerët</li> </ul>
Përcaktorët socialë dhe kulturorë të seksualitetit (vlerat dhe normat)	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ ndikimi i presionit të bashkëmoshatarëve, medias, pornografisë, kulturës, fesë, gjinive, normave ligjore si dhe e statusit socio-ekonomik mbi vendimet seksuale, partnetitetin dhe mënyrat e sjelljes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ të diskutojmë në lidhje me ndikimin e jashtme dhe të bëjmë një vlerësim personal të saj</li> <li>• të fitojmë kompetenca në lidhje me trajtimin e mediave moderne (telefon celular, internet, mënyra e veprimtimit me pornografinë)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>■ respektimi i stileve të ndryshme të jetesës, i vlerave dhe normave</li> <li>• pranimi i mendimeve të ndryshme, i pikëpamjeve dhe i mënyrës së sjelljes me seksualitetin</li> </ul>

\* International Planned Parenthood Federation (IPPF): Sexual Rights: an IPPF declaration. London 2008 und World Association for Sexual Health (WAS): Declaration of Sexual Rights. Hongkong 1999

■ Tema kryesore (e

■ Tema kryesore (thellim)

• Tema shtesë (e

• Tema shtesë (thellim)

# 12–15

## Njohuritë

Vënia në dispozicion e informacioneve

## Kompetencat

Aftësi i fëmijëve

## Mendimet

Përkrahja e zhvillimit të mendimeve pozitive

Trupi i njeriut dhe zhvillimi njerëzor

- njohuritë për trupin, imazhi i trupit dhe kulti i trupit (gjymtimi i gjenitaleve tek vajzat, bërja synet, cipa e virgjërisë dhe riformimi i cipës së virgjërisë, anoreksia, bulimia, piercing-u dhe tatuazhet)
- cikli i menstruacioneve; karakteristikat sekondare fizike të gjinive, funksioni i tyre tek burrat dhe gratë dhe ndjenjat që janë të lidhura me to
- *idealet e bukurisë nëpër media; ndryshimet e trupit gjatë jetës*
- *zyrat e shërbimit për adoleshentët, për problemet që kanë të bëjnë me to*

- të përshkruajmë se si mund të ndikojë qendrimi që kemi për trupin tonë, shëndetin, imazhin për vetëveten dhe sjelljen
- *të angazhohemi me pubertetin dhe t'i rezistojmë presionit të bashkëmoshatarëve*
- *të jemi kritik ndaj mesazheve përcjellëse të mediave dhe industrisë së bukurisë*

- *qendrim kritik ndaj kulteve në lidhje me trupin*
- *njohja dhe vlerësimi i formave të ndryshme të trupit*

Fertiliteti dhe shumimi

- ndikimet (e mëparshme) nga lidhja me nënën dhe babain (rëndësia e edukimit të fëmijës – planifikimi i familjes, planifikimi i karrierës, kontracepsioni, vendimmarrja dhe përkujdesja gjatë një shtatzënie të padëshiruar)
- informacionet në lidhje me qendrat e konsultimit për kontracepsionin
- kontracepsion i paefekshëm dhe shkaqet e tij (konsumimi i alkoolit, efektet dytësore, harresa, pabarazia e gjinive etj.)
- shtatzënia (edhe në marrëdhëniet e të njëjtës gjini) dhe infertiliteti
- mitet dhe faktet (besueshmëria, avantazhet dhe disavantazhet) e mjeteve të ndryshme të kontracepsionit (përfshirë të ashtuquajturin kontracepsion i urgjencës)

- të njohim shenjat dhe simptomat e shtatzënisë
- të marrim mjetet e kontracepsionit nga një vend caktuar për këtë, si për shembull nëpërmjet shkuarjes tek një specialist mjekesor
- të vendosim me vetëdije, nëse duam të kemi përvoja seksuale apo jo
- *të shkëmbejmë informacione në lidhje me kontracepsionin*
- *të zgjedhim me vetëdije mjetet e kontracepsionit dhe të përdorim në mënyrë efektive mjetin e zgjedhur të kontracepsionit*

- qëndrimi personal (normat dhe vlerat) për lidhjen (e mëparshme) me nënën dhe babain, kontracepsionin, abortin dhe adoptimin
- qendrim pozitiv në lidhje me përgjegjësinë e dyanshme për kontracepsionin

■ Tema kryesore (e

■ Tema kryesore (thellim)

• Tema shtesë (e

• Tema shtesë (thellim)

# 12–15

## Njohuritë

Vënia në dispozicion e informacioneve

## Kompetencat

Aftësi i fëmijëve

## Mendimet

Përkrahja e zhvillimit të mendimeve pozitive

### Seksualiteti

■ pritshmëria e individit dhe sjellja e tij në lidhje me rolin që ai luan në eksitim seksual, dhe dallimet specifike gjinore (gender differences)

- identiteti i gjinive dhe orientimi seksual, përfshirë Coming-out dhe homoseksualitetin
- shijimi i seksualitetit (t'i japësh vetes kohë)
- përvoja e parë seksuale
- dëshira, masturbimi, orgazma

■ komunikimi dhe negociatat në marrëdhëniet intime

- si të marrim vendime me vullnet të lirë dhe me përgjegjësi të plotë, pas analizimit të pasojave si dhe të pikave favorizuese dhe disfavorizuese të çdo vendimi të marrë (partnerja/partneri, sjellja seksuale)
- të shijojmë seksualitetin në mënyrë të respektueshme
- të dallojmë midis seksualitetit në jetën reale dhe seksualitetit nëpër media

■ mirëkuptim për seksualitetin si një proces i të mësuarit

- respekt dhe mirëkuptim për shumëllojshmërinë dhe orientimin seksual dhe pranimin e tij (seksi duhet të kryhet me konsens, me vullnet të lirë, të barabartë, sipas moshës, të kryhet në kontekstin e përshatshëm; vetëvlerësimi duhet të ruhet)

### Emocionet

■ dallimet midis miqësisë, dashurisë dhe dëshirës

■ emocione të ndryshme si kureshtje, të qenurit i dashuruar, pasiguri, turp, frikë dhe xhelozia

■ si të shprehim miqësinë dhe dashurinë në mënyra të ndryshme

■ si të shprehim nevojat dhe dëshirat tona, të vendosim kufijtë dhe të respektojmë të tjerët

- të dimë si të veprojmë me emocionet e ndryshme dhe kontradiktore, ndjenjat dhe dëshirat

■ pranimi, që njerëzit kanë ndjenja të ndryshme (për shkak të gjinisë së tyre, të kulturës dhe të përkatësisë fetare, etj. si dhe për shkak të interpretimit të tyre)

### Marrëdhëniet dhe stilet e jetesës

■ influenca e gjinisë, moshës, fesë dhe kulturës

■ stile të ndryshme komunikimi (verbale dhe joverbale) dhe si mund të përmirësohen ato

- ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve
- strukturat familjare dhe ndryshimet (psh. prindi që rrit fëmijën i vetëm)
- lloje të ndryshme të marrëdhënieve (të këndshme dhe të pakëndshme), familjet dhe format e jetesës

■ të flasim rreth sjelljes së padrejtë dhe diskriminuese si dhe rreth trajtimit të pababarabartë

■ të shprehim miqësinë dhe dashurinë në mënyra të ndryshme

■ të krijojmë kontakte sociale, të lidhim shoqëri dhe të ndërtojmë e të ruajmë marrëdhëniet

- të komunikojmë pritshmërinë dhe nevojat tona në një marrëdhënie

